

**RAPORT**  
**I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK**

**Për Programin e studimit MP në “Marketing” me profile:**


- Shërbime dhe turizëm
- Inovacion dhe tregje strategjike
- Marketing Bankar e financiar

**Ofruar nga Universiteti European i Tiranës**

**Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:**

**Prof. Dr Shyqyri LLACI**

**Prof.As. Vita KOJA**



**Qershor / 2018**

## **RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

### **Për Programin e studimit MP në Marketing me profile:**

- Shërbime dhe turizëm;
- Inovacion dhe tregje strategjike;
- Marketing Bankar e financiar;

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Universiteti Europian i Tiranes
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 74, datë 21.01.2009
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr.68 date 14.02.2011
5	Titulli i programit të studimit:	MP në Marketing me profile : • Shërbime dhe turizëm; • Inovacion dhe tregje strategjike; • Marketing Bankar dhe financiar;
6	Cikli i studimit:	Cikli i dytë i studimit
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik *
8	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	-
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
16	Numri i studenteve per program studimi	29 *

\*Numri i studentëve i përket viti akademik 2017 - 2018

**Shenim:** Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

## **HYRJE**

### **Të dhëna për programin e studimit**

Universiteti European i Tiranës si institucion i Arsimit të Lartë është krijuar fillimi si Shkollë e Lartë Universitare Jo Publike me VKM nr. 636 datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jo Publike. Me VKM nr. 657, datë 28.09.2011 emërtimi i institucionit është ndryshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës", në "Universiteti European i Tiranës".

Programi Master Profesional në Marketing me profile, i cili po vlerësohet për riakreditim operon në mënyrë të pandërprerë prej vitit 2009, i licensuar me VKM Nr.74, datë 21.1.2009. Pas akreditimit të parë me Urdhër Nr. 68, dt 14.02.2011 të Ministrit të Arsimit, kurrikula e programit të studimit është organizuar në mënyrë të tillë, që studenti të marrë formimin e duhur professional sipas profilit të zgjedhur dhe në vijimsi, ajo është rishikuar dhe përditësuar, në funksion të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, mësimnxënies si dhe nxitjes së kërkimit shkencor, objektiva të cilat UET i ka përbushur siç evidentohet edhe nga raporti i vlerësimit të jashtëm, proces ky i zhvilluar nga ASCAL dhe me asistencën e Agjencisë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA.

Grupi i Vlerësimit të Jashtem (GVJ) per realizimin e procesit të vlerësimit u mbështet në një seri dokumentash dhe kërkesash të ndryshme në lidhje me standarde me mënyrën e funksionimit të gjithë strukturave të Universitetit European të Tiranes. Burim i rëndësishëm për vlerësimin e jashtëm shërbeu Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, i cili ishte rezultat i bashkëpunimit ndërmjet stafit akademik dhe atij administrativ të UET. Një rol të rëndësishëm në ketë vlerësim kishin edhe vizitat në vend që u realizuan pranë UET-se, takimet me drejtues të këtij institucioni si shqyrtimi i dokumentacionit bazë mbi të cilën organizohet i gjithë programi i studimit.

### **GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)**

#### **Përbërja e GVJ:**

**Prof.Dr.Shyqyri LLACI**

**Prof.As.Vita KOJA**

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Më datë 14.06.2018 përmes sistemit dhe me shkresë zyrtare me Nr. 15/26 Prot me lëndë:" Dërgohen Draft Raportet e Vlerësimit të Jashtëm", UET është njojur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. UET përcjell në ASCAL nëpërmjet shkresës me nr. 10/32 prot, datë 20.06.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes komentet ndaj draft rapportit vendosi të mos bëj ndryshim në këtë draft report. Ky draft mer formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

# ANALİZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

## I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Në procesin e akreditimit të parë, të ralizuar nga Prof. Dr. Ilia Kristo, në lidhje me programin Master Profesional në Marketing me profile: a. Shërbime dhe turizëm; b. Inovacion dhe tregje strategjike; c. Marketing bankar e finansiar janë dhënë disa rekomandime si më poshtë:

- a) **Struktura organizative:** Rishqyrtimi dhe organizimi i procesit të manaxhimit dhe vendimmarjes në edukimin mbi bachelor, duke konsideruar departamentet, fakultetet, manaxhimin operativ dhe mendimmarrës në nivel universiteti.
- b) **Staf:** Departamenti duhet të shohë me përparësi kompletimin e stafit të brenshëm me staf mësimdhënës që zotëron ekspertizë të thedhuar marketing kombinuar me përvojë akademike. Prurja e ekspertizave më të thelluara e të detajuara të marketingut nga specialistë të kualifikuar të vendit e të jashtëm qoftë edhe në formën e “gest speaker” i është sygjeruar dhe pranuar nga drejtuesit e UET.
- c) **Mësimdhënia:** Një kërkim i thelluar i tregut të punës për specialist marketingu mund të ndërmerret nga UET, që mund të sygjeronte një rishikim të kurrikulave dhe profileve, pas feedbackut të të diplomuarve të parë dhe ecurisë së studentëve, që në mënyrë intuitive reflektojnë tregun e punës. Kurrikulat mësimore duhet të përcaktojnë më qartë (të thjeshtojnë) literatureën bazë të detyruar, pasi në disa lëndë ajo është e mbingarkuar.
- d) **Bashëpunimet:** Në procesin e bashkëpunimit me universitete të huaja të synohet gjenerimi i sëpecialistëve nga fusha të detajuara marketing, më shumë se sa të formimit të përgjithshëm, që mund të sigurohen më lehtë lokalisht.
- e) **Studentët:** Të vendosen kritere më rigorozë për pranimin e studentëve (p.sh. nota mesatare mbi 7), dhe sidomos njohja e gjuhës angleze, që do të bënte më të lehtë segmentimin në harmoni me filozofinë e UET.
- f) **Kërkimi shkencor:** Të synohet integrimi i studentëve në procesin kërkimor të padagogëve, si pjesë integrale e procesit mësimor.
- g) **Infrastruktura dhe lehtësirat:** Të pasurohet fondi i bibliotekës, në veçanti me titujt e përfshirë në kurrikulat mësimore të lëndëve. Një skanim më i kujdesëshëm i burimeve vendase të literatureës, një përzgjedhje më e kujdesëshme dhe përkthim professional dhe teknik të titujve në përputhje me politikën e lavdërueshme dhe misionin në këtë drejtim të UET.

## II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. **Për rekomandimin lidhur me strukturat organizative,** Departamenti i “Manaxhimit dhe Marketingut” është përgjegjës për zhvillimin e programit Master profesional me tre profile. Në këtë departament ashtu si edhe në departamentet e tjera, për mbarëvajtjen e procesit mësimor në të gjitha nivelet, lëndët që mbulojnë tematika të ngjashme janë të organizuara në grup-lëndë. Përgjegjësi i çdo grup-lëndësh emërohet nga Dekani me propozim të Përgjegjësit të Departamentit dhe është përgjegjës për përbajtjen e grup-lëndëve përkatëse, garanton respektimin e parimeve metodologjike të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuara dhe përditësimin e tyre me të rejat e shkencave përkatëse. Përgjegjësi i grup-lëndëve miraton tezat e provimeve, temat e detyrave të kursit, shqyrton programet e lëndëve si dhe bashkëpunon me grupet e kërkimit në fushën specifike. Ai gjithashtu kontrollon përputhshmërinë e temave të diplomës me aksin kërkimor të pedagogut udhëheqës. Institucioni është përpjekur të garantojë në çdo rast që përkatësia e pedagogut në një grup-lëndë, të

përkojë edhe me përkatësinë e tij në grupin kërkimor të udhëhequr nga një prej profesorëve të grup-lendës përkatëse. Në UET janë krijuar dhe grupet kërkimore, të cilat udhëhiqen nga personel akademik i kategorisë Profesor dhe përfshijnë anëtarët e tjerë të personelit akademik, të cilët kanë kompetencë në të njëjtën fushë kërkimore. Pjesë e grupeve kërkimore janë doktorantët sikurse dhe studentët e ciklit të dytë të studimeve, në ato raste kur tema e tyre përkon me projektin kërkimor.. Në UET ekzistojnë të gjitha strukturat, përgjegjëse për organizimin e procesit të manaxhimit dhe të vendimmarrjes në të gjitha nivelet e edukimit. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht**

b. **Për rekomandimin lidhur me stafin**, institucioni ka bërë përpjekje për plotësimin e departamentit përgjegjës për këtë program me pedagogë të brendshëm (sot rreth 90% e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie janë të brendshëm). Institucioni ndjek dhe mbështet rrjetin së shkallës së kualifikimit të personelit akademik në fushat përkatëse me veprimtari didaktike, trajnime, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në konferanca shkencore brenda dhe jashtë vendit, me publikimin e punës së tyre kërkimore dhe me mbështetje financiare në formën e granteve kërkimore. Ai ka mbështetur kualifikimin e pedagogëve për të ndjekur studimet e doktoratës në UET, ose në institucionet jashtë vendit, duke akorduar periudha disa mujore kërkimi shkencor të paguar. Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve realizohet në kuadër të shumë projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit European; etj. sipas aplikimeve individuale të stafit për të kryer periudha kërkimore në universitete të tjera jashtë. Të gjithë titullarët e lëndëve që zhvillohen në këtë program studimesh kanë minimalisht gradën shkencore doktor. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

c. **Për rekomandimin në lidhje me mësimdhënien**. UET gjatë viteve ka rrishkuar kurrikulat mësimore të profileve në përshtatje me kërkuesat e tregut të punës. Duke vlerësuar se në ciklin e e dytë të studimeve master, ku njohuritë dhe aftësitë e studentëve duhet të avancohen dhe thellohen, në UET për çdo lëndë literatura bazohet në 2-3 tekste bazë dhe 10-15 materiale si literaturë e rekomanduar. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

d. **Për rekomandimin në lidhje me bashkëpunimet**, UET ka një bashkëpunim të gjerë me mjaft institucionet të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit publik dhe atij privat me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Në funksion të shkëmbimit të përvojave me universitetet e tjera vendase apo të huaja, sikurse dhe për të qenë sa më pranë kërkesave të tregut të punës, UET ka institucionalizuar angazhimin e lektorëve të ftuar si dhe përfshirjen e ekspertëve të fushave të ndryshme në ato lëndë ku gjyket se përfshirja e ekspertëve është e rëndësishme, pasi ekspertët e ftuar janë emra të spikatur në fushën ekonomike, juridike, politike dhe sociale. Gjithashtu, institucioni bashkëpunon me profesorë të huaj, në udhëheqje temash doktorature dhe në konferanca ndërkombëtare që organizohen nga UET. **Ky rekomandim është plotësuar plotësisht.**

- e. **Për rekondimin në lidhje me studentët**, duke qenë se kuotat janë të kufizuara, institucioni përzgjedh kandidatët të cilët kanë mesataren më të lartë, në ato raste kur aplikimet janë më të larta se kuotat. Për sa i përket kriterit të njohjes së gjuhës së huaj, kjo çështje rregullohet nga legjislacioni për arsimin e lartë në fuqi, prandaj mendojmë se ky **rekondim eshtë plotësuar plotësisht**.
- f. **Për rekondimin në lidhje me integrimin e studentëve në kërkimin shkencor**, institucioni ndjek politika të mbështetjes dhe nxitjes së përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet: përfshirjes së studentëve në projektet kërkimore të pedagogëve; udhëheqjes së punimeve të diplomës të cilat bazohen në parimet, metodologjinë dhe instrumentet bashkëkohore të kërkimit shkencor; përfshirjes së studentëve në projektet ku UET eshtë partner dhe mobilitetit të tyre në kuadër të programeve Erasmus+. **Ky rekondim eshtë plotësuar kryesisht**, pasi studentët e Masterit Professional në Marketing nuk janë të angazhuar në asnje lloj projekti studimi, qofshin këto studime tregu apo projekte kërkimore-shkencore në bashëpunim me pedagogët.
- g. **Për rekondimin në lidhje me infrastrukturën dhe lehtësirat**, biblioteka e UET disponon literaturë që ndihmon studentin në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore përkatëse. Pasurimi i saj eshtë një përpjekje dhe objektiv i vazhdueshëm i institucionit, duke marrë parasysh dinamikën e publikimeve brenda dhe jashtë vendit. Gjithashtu janë kryer abonime në biblioteka virtuale si: Sage, Ebsco dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë. **Ky rekondim eshtë plotësuar plotësisht**.

## 1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënisë dhe kërkimit shkencor, strategjite afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Hartimi i programit të studimit Master Profesional (MP) në Markeitng është bazuar në misionin që ka vetë UET i cili kërkon të arrijë një nivel cilësie të lartë në formimin akademik të studentëve dhe përgatitjen e specialistëve dhe kërkuesve të rinj në fushën e marketingut me dije të qëndrueshme teoriko praktike. Programi i studimit Master Profesional Marketing me profile: ofron formim praktik të studentëve sipas profilit, me qëllim arritjen e objektivave profesionale dhe kualifikimin e tyre në këtë fushë.

Programi i studimit në këtë master krijon mundësi për studentët, që të fitojnë njohuri të specializuara në marketing përmes detyrave dhe projektit të diplomës në përfundim të studimit si dhe u siguron atyre eksperiencë dhe lidhje me praktikën, duke mundësuar aplikimin e njohurive, teknikat dhe aftësitet e tyre për të zgjidhur problemet në praktikë.



Programi i studimit Master Profesional Marketing me profile, formon ekspertë dhe specialistë të aftë në aspektet teorike si dhe praktike aplikative në fushën e marketingut të aplikuar në turizëm, në sistemin banker dhe në inovacion, duke i pajisur ato me njohuritë teorike, me praktikat bashkëkohore ndërkombëtare dhe me përvojën shqiptare në fushën e marketingut të shërbimeve, në sektorë të ndryshëm të biznesit dhe të ekonomisë.

Programi bazuar në kurrikulën e tij ofron mundësi të mira për punësimin e studentëve në shumë drejtime si: specialistë e drejtues të zyrave të marketingut, të shitjeve dhe marrëdhënieve me klientët në bizneset që ofrojnë shërbimet sipas profileve të programit, specialistë e drejtues të agjencive turistike, të agjencive publicitare, të shërbimeve të ndryshme në sektorin financiar, bankar dhe atë të sigurimeve etj.

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve <sup>1</sup>
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b>	
Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;	Programi i studimit “Master Profesional Marketing” me profilet: shërbime dhe turizëm, inovacion dhe tregje strategjike, marketing bankar e financiar është hartuar në bazë të misionit të UET, për t’ju dhënë studentëve një edukim cilësor, duke u mbështetur në studimin e bërë nga ky institucion mbi nevojat e tregut dhe përspektivat ekonomike të vendit. Programet e lëndëve dëshmojnë për vullnetin e institucionit, për rriten e ndërgjegjësimit të studenteve ndaj vlerave kulturore të kombit.
Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;	
Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;	
Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit përruajtjen e vlerave kulturore të kombit.	
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b>	
Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;	Programi i studimit “Master Profesional Marketing” me profilet: shërbime dhe turizëm, inovacion dhe tregje strategjike, marketing bankar e financiar, përshtatet me objektivat strategjike të zhvillimit të

<sup>1</sup> GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përbushjen e standardeve në tërësi.



UET, që janë arritja e ekselencës në aktivitetet akademike dhe ato të kërkimit, angazhimi i një personeli me vlera dhe aftësi të larta profesionale, sigurimi i një cilësie të lartë në procesin akademik, pajisja e studentëve me edukim më të mirë, me qëllim që të rrisin aftësitë dhe ekseriencën e tyre, bashkëpunimi kombëtar, rajonal dh endërkombëtar, krijimi I një mjedisi nxitës dhe zhvillues etj.

### **Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.**

**Kriteri 1** Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;

**Kriteri 2** Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.

Programi i studimit MP në Marketing me profile është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Nga shqyrtimi i materialeve të DVV, vërehet se përbajtja e programit të studimit është në përputhje me aktet ligjore në fuqi, dhe emërtimi i programit përpunhet me nivelin e përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit, specifikuar në Ligjin Nr. 10247/04.03.2010.

### **Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënës.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucional për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucional për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënës.

Në planin strategjik të hartuar nga UET-ja janë përcaktuar edhe drejtimet kryesore të përmirësimeve për programet e vecanta që zhvillohen nga institucioni. Nga materialet e përgatitura nga GVB si dhe nga vizita në institucion shihet që ky institucion harton plane strategjike me qëllim evidentimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënës si dhe përmirësimin e mëtejshëm të këtyre rezultateve npërmjet përmirësimit të programeve të studimeve. UET ka hartuar planin strategjik 5 vjeçar (2015-2020), pjesë e të cilit është edhe zhvillimi dhe përmirësimi i programeve të studimit.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Programi i studimit Master Profesional Marketing, është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë për zhvillim të UET, me kërkesat e tregut të punës për specialistë të aftë në këtë fushë si dhe me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Veprimtaria e UET bazohet në hartimin e planeve, ku integrohet menaxhimi i institucionit me menaxhimin e programeve të studimit që ofrohen prej tij.

GVJ konstaton se në këtë rubrikë standardet plotësohen plotësisht.

## **2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënavë të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhëni së informacionit

UET e bazon veprimtarinë e tij në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të akteve të tjera nënligjore mbi arsimin e lartë, të Statutit të Universitetit, Rregullores Bazë të tij dhe të akteve të tjera rregullatore të institucionit. Ai hapi dyert për studentët fillimisht si Shkollë e Lartë Universitare Jopublike me Vendimin Nr. 636, datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave “Për dhënien e lejes për

hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës. UET është akredituar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 246, datë 24.07.2009, ndërsa Programet "Master i Shkencave," "Master Profesional" dhe "Master i Nivelit të Dytë", janë akredituar me urdhër Nr. 68, datë 14.02.2011. Emërtimi i institucionit ka ndryshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës, në "Universiteti European i Tiranës, me VKM nr. 657, datë 28.09.2011

Universiteti European i Tiranës përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative. Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete: 1, Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, 2, Fakulteti Juridik dhe 3, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra). Në strukturën e UET renditen edhe njësítë administrative e mbështetëse. Gjatë viteve pas akreditimit të parë, struktura organizative e UET ka pësuar ndryshime sasiore dhe cilësore. Ndryshimt sasiore shihen në angazhimin e një numri në rritje të stafit akademik në përbushjen e programeve të ofruara, ndërsa ndryshimet cilësore shihen kryesisht në rekrutimin e një stafi të kualifikuar me grada shkencore, tituj akademik dhe eksperience mesimore shkencore

Për zhvillimin e veprimitarise akademike në rang universiteti janë angazhuar 186 pedagogë, nga të cilët 132 të brendshëm dhe 69 të jashtëm; të ndihmuar nga 68 punonjës të strukturave administrative. Struktura organizative e UET ka pësuar përmirësim, sidomos në drejtim të fuqizimit të veprimitarise së pavarrur të departamenteve, forcimit të rolit koordinues në nivel fakulteti, përmirësimit të administrimit dhe strukturës organizative të universitetit. Struktura organizative përbëhet disa njësi administrative në mbështetje të mbarëvajtjes së procesit mësimor, të kërkimit shkencor, si edhe të jetës studentore dhe veprimitarive ekstrakurrikulare. UET në përputhje me misionin dhe objektivat e tij, i ka dhënë rëndësi fuqizimit të kërkimit shkencor, përcaktimit qartë i drejtimeve kryesore të kërkimit në nivel departamenti e më gjerë në shkallë universiteti si dhe krijimi i strukturave mbështetëse në këtë drejtim. Ku, në mbështetje të kërkimit shkencor, veçanërisht në përfshirjen më të gjerë të stafit të UET, funksionon Zyra e Projekteve të Kërkimit dhe Zhvillimit.

Programi MP në Marketing me profile zhvillohet kryesisht nga Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut që është një nga tre departamentet e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjise së Informacionit pranë UET-së si më poshtë:

- Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit
- Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
- Departamenti i Matematikës Informatikës, dhe Statistikës.

UET në përbushjen e misionit të tij, ka në fokus: sigurimin e cilësisë akademike nëpërmjet rritjes së cilësisë së mësimdhënie, zhvillimin e veprimitarise kërkimore-shkencore në shërbim të nevojave dhe prioriteteve të zhvillimit të vendit, rritjen e investimeve dhe burimeve financiare për mësimdhënien, inovacionin dhe punën kërkimore shkencore, rritjen e kontributit për zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, përgjegjësinë sociale, rritjen e përgjegjësisë në ndihmë të grupeve të popullsisë në nevojë dhe cilësisë së jetës së popullsisë së vendit, ofrimin e programeve të reja të studimit në përputhje me kërkesat e tregut të punës etj.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit**

Përgjegjës për zhvillimin e programit të studimit "Master Profesional në Marketing me profile" është Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, si pjesë e organigramës së UET, ku, janë specifikuar stafi drejtues dhe mësimdhënës, detyrat, kompetencat si dhe përgjegjësitë e tyre (**figura 1, Aneksi 1**). Të tre fakultetet në përbërje të këtij institucioni si Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, janë të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra) si dhe me njësítë administrative e mbështetëse të cilët paraqiten në **Tabelat 1 dhe 2 Aneksi 1**.

Në përbërje të Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit funksionojnë tre departamente: Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit dhe Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës, ku Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut është përgjegjës për zhvillimin e programit që po riakreditohet. Të dhëna mbi Fakultetin Ekonomik dhe studentët që kanë frekuentuar programet e tij, sipas ciklevit, në tre vitet e fundit akademike paraqiten në skedën informative mbi fakultetin (**tabela 3, Aneksi 1**), ku, shihet për programet Master Profesional, që ofron Fakulteti, ka një rritje të studentëve rreth 54% për 3 vitet e fundit. Konkrektisht për programin MP në Marketing, numri i studentëve që kanë ndjekur studimet në vitin akademik 2016-2017 është 76% më i lartë krahasuar me numrin e studentëve të këtij programi studimi në vitin 2014-2015.

Fakti që pranë këtij Fakulteti ndjekin studimet 54.5% e studentëve të programeve Bachelor të UET, rreth 53.4% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master i Shkencave dhe 71% e studentëve që ndjekin studimet në programet Master Profesional që ofron universiteti, flet për interesin e studentëve, për të studiuar pranë këtij fakulteti, për larminë e profileve që ofrohen, cilësinë e zhvillimit të proceseve akademike si dhe për mundësitet e tjera që siguron universiteti. Në këtë fakultet, duke filluar nga viti akademik 2010–2011 zhvillohen edhe programet e studimit MSH në Informatikë Ekonomike dhe MP në Informatikë të Aplikuar, ndërsa në Ciklin e Parë të studimeve zhvillohet edhe programi: Bachelor në Informatikë ekonomike me dy profile.

#### **Struktura akademike e Fakultetit /Departamentit**

Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij **82** personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej **52** persona, nga të cilët **29** janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej **30**, nga të cilët **19** me tituj/grada. Në aneksin e këtij raporti në tabelën nr.1 jepen të dhëna më të detajuara.

Për mbarëvajtjen e procesit mësimor departamentet janë organizuar në mënyrë të tillë që, të gjitha, lëndët që mbulojnë tematika të ngjashme të organizohen në grup-lëndë (seksione), përgjegjësi i çdo grup-lëndësh emërohet nga dekani me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe është përgjegjës për përbajtjen e lëndëve përkatëse në grup, garanton respektimin e parimeve metodologjike të përcaktuara në aktet rregullatore të miratuar dhe përditësimin e programeve me të rejat e shkencave përkatëse. Përgjegjësi i grup-lëndëve miraton tezat e provimeve, temat e detyrave të kursit, shqyrton programet e lëndëve si dhe bashkëpunon me grupet e kërkimit në fushën specifike. Ai gjithashtu kontrollon përputhshmërinë e temave të diplomës me aksin kërkimor të pedagogut udhëheqës. Institucioni është përpjekur të garantojë në çdo rast që përkatësia e pedagogut në një grup-lëndë, të përkojë edhe me përkatësinë e tij në grupin kërkimor të udhëhequr nga një prej profesorëve të grup-lëndës përkatëse.

Në UET janë krijuar dhe grupet kërkimore, të cilat udhëhiqen nga personel akademik i kategorisë profesor dhe përfshijnë anëtarët e tjerë të personelit akademik, të cilët kanë kompetencë në të njëjtën fushë kërkimore. Pjesë e grupeve kërkimore janë doktorantët sikurse dhe studentët e ciklit të dytë të studimeve, në ato raste kur tema e tyre përkon me projektin kërkimor. Ngarkesa e personelit akademik përfshin katër lloje veprimtarish: mësimdhënien dhe kualifikimin e vazhdueshëm profesional, kërkimin shkencor, shkëmbimin e njohurive dhe shërbimeve teknologjike dhe detyrat administrative. Zhvillimi i burimeve njerëzore ka qenë në qendër të vëmendjes, nëpërmjet kualifikimeve jashtë vendit, kurseve afatshkurtra dhe afatgjata për metodat e mësimdhënies, promovimit profesional dhe përgjigjeve institucionale ndaj kërkimesave të studentëve. Gjithnjë i është kushtuar vëmendje baraspeshimit të angazhimeve të personelit akademik, ngarkesës akademike të pedagogëve dhe performancës cilësore të tyre. Gjatë periudhës që po shqyrtojmë vërehen përmirësimë si në reportin PAE/PAK duke i dhënë përparrësi personelit akademik efektiv, ashtu edhe në treguesit cilësor të tij. Institucioni ka politika të mbështetjes dhe ndjekjes së rritjes së shkallës së kualifikimit të personelit akademik dhe nxit kualifikimin e mëtejshëm të personelit dhe sot të gjithë titullarët e lëndëve që zhvillohen në ciklin e dytë të studimeve kanë gradën shkencore doktor.



Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut si njësia që mbalon këtë program ka patur ecurinë e zhvillimit sasior dhe cilësor që përmendëm më lart dhe që shprehet në të dhënrat si si më poshtë:

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti përbëhet nga **12 (PAE)** **9 me tituj/grada**, dhe **6 (PAK) 6 me tituj/grada.**

Për vitin akademik 2017-2018 Departamenti përbëhet nga **13 (PAE)** **11 me tituj/grada**, dhe **5 (PAK) 4 me tituj/grada.** (Të dhënrat jepen në **Tabelat 3 dhe 3.1 ne Aneksin 2**)

**Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion**

Informacionet mbi strukturën organizative të këtij institucioni, organet e zgjedhura drejtuese në të gjitha nivelet, përbërjen e departamenteve etj. janë marrë nga vizita e bërë në institucion si dhe nga konsultimi me materialet e GVB.

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përbushjen e misionit të tij.</b>	<p>Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të DVV dhe vizitës në institucion u konstatua se UET organizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në mënyrë që të pëmbushë misionin vet.</p> <p>Universiteti përbëhet nga 3 Fakultete:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Fakulteti Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit</li> <li>b. Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit</li> <li>c. Fakulteti Juridik</li> </ul> <p>Dy fakultetet e para janë të organizuara në 3 Departamente, ndërsa Fakulteti Juridik në 2 Departamente dhe 1 Qendër kërkimore. Fakultetit Ekonomik dhe IT ka një Personeli akademik prej 52 anëtarësh, të angazhuar me kohë të plotë, ku, 29 prej të cilëve janë me grada dhe tituj akademik.</p> <p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut, që është përgjegjës për programin e studimit MP në Marketing me profile, në vitin aktual 2017-2018 ka <b>13</b> personel akademik efektiv (PAE) nga ku, <b>11</b> prej të cilëve janë me grada e tituj, dhe dhe <b>5</b> personel akademik me kontratë (PAK) nga të cilët <b>4</b> janë me tituj/gradë.</p>
<b>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</b>	<p>Ashtu siç u pa edhe në materialet e përgatitura nga GVB, departamentet si njësi bazë janë përgjegjëse për realizimin e programeve të studimeve dhe përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij. Ndërfunkcionet kryesore të departamentit përmendim: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve që gjykohen të nevojshme; shqyrtimin dhe miratimin propozimeve të përgjegjësve të grup-lëndëve për tekstet</p>
<b>Kriteri 1</b> Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;	
<b>Kriteri 2</b> Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.	

	mësimore që do të përdoren në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit sipas planit të miratuar dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënies. Është departamenti ai që propozon profilin e nevojshëm të kandidatit për plotësimin e vendit vakant, në përputhje me ngarkesën mësimore.
--	---

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Duke shqyrtuar dosjen e vetylë vlerësimit, por edhe diskutimet që u kryen gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentacioni që u paraqit për grupin e vlerësimit të jashtëm, GVJ vlerëson se;

1. Struktura akademike e Fakultetit Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit, si dhe Departamentit të Menaxhimit dhe Marketingut si njësia bazë e cila mbulon zhvillimin dhe administrimin e programit të studimit MP në Marketing me profile,është e organizuar në përputhje me kërkuesat ligjore në fuqi, dhe nevojat e këtyre njësive për të realizuar me cilësi programet e studimit në këtë program.
2. Institucioni është organizuar në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi dhe objektivat e tij për të ofruar programe studimi cilësore. Struktura organizative e ndihmon UET të realizojë misionin e tij.
3. Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut është i angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Professional në Marketing dhe ka detyra të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit.
4. Përgjegjësi i departamentit është i përfshirë si në procesin e rekrutimit të personelit akademik të njësisë së tij, si dhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë.
5. Institucioni ka një strukturë të kompletuar administrative, që mbështet departamentet në punën e tyre, duke u ofruar shërbime të specializuara studentëve.

GVJ konstaton se në këtë rubrikë **standardet plotësohen plotësisht.**

### **3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Termë reference:** Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Veprimtaria e mësimdhënies dhe e kërkimit shkencor në UET, zhvillohet nga personeli akademik dhe së bashku me drejtuesit e universitetit kryejnë edhe shërbime të tjera për zhvillimin e institucionit si: këshillim për studentët dhe detyra administrative sipas përcaktimeve në Statutin e UET dhe Kontratës së lidhur mes tyre dhe institucionit. Nga shqyrtimi i dosjes së vetylë vlerësimit, si dhe vizita në institucion u konstatua se në UET personeli akademik funksionon si personel i punësuar me kohë të plotë, me kontratë me afat ose pa afat, ku, përfshihen drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe pedagogët senior dhe personeli akademik me kohë të pjesshme, që përbëhet nga personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar.

Rekrutimi i personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre në UET rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e institucionit dhe me dokument të veçantë. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik, përcaktohen në Kontratën e lidhur mes tij dhe institucionit, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e tij, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në dokumente të tjera të miratuara nga organet drejtuese e UET.

Kriteret kryesore mbi të cilat mbështetet vlerësimi/rekrutimi i kandidaturave për këtë program studimi janë:

- Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar,
- Të ketë së paku gardë shkencore PhD ose Doktor, si dhe tituj Prof/Prof.As,

- Cilësia dhe standartet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke i dhënë përparësi universiteteve perëndimore,
- Rezultatet personale të kandidatit,
- Aftësitë komunikuese dhe etika,
- Zotërimi i gjuhëve të huaja dhe shkalla e përdorimit të tyre etj.

Institucioni për nevoja të veçanta të programit mësimor, të tilla si për mësimdhënie në lëndë me karakter praktik, cikle specifike leksionesh dhe seminaresh, orësh praktike, etj., në periudha të caktuara të procesit mësimor, përvèç pedagogëve me tituj e grada, punëson edhe pedagogë që nuk kanë tituj e grada, por që kanë një përvojë të gjatë e të suksesshme në profesion dhe në institucionet e tyre ose janë unikë në fushën e tyre të specializimit.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Struktura didaktike (seksionet) për departamentet ose programin e studimit**

Struktura didaktike e departamentit, që drejton programin e studimit Master Profesional në Marketing me profile përbëhet nga pedagogë efektivë dhe me kontratë, ku, stafi akademik i angazhuar drejtpërsëdrejti për këtë program në vitin aktual 2017-2018 përbëhet nga 9 pedagogë efektivë(PAE) ku 4 anëtarë efektivë janë me gradën shkencore “Doktor”, 3 anëtarë efektivë janë me titull Prof. As. Dr, dhe 2 anëtarë efektivë janëme titull Prof. Dr, dhe 1 pedagog me kontratë(PAK) me gradën shkencore “Doktor”.

**Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), tituj/gradat, (Plotëso Tabelat 1 dhe 2 në Aneks, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB)**

Në Fakultetin Ekonomik dhe të Teknologjisë së Informacionit zhvillohen 4 programe studimi të Ciklit të Parë (BA); 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 5 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 1 program të Ciklit të Tretë (Doktoraturë), ku, për realizimin e tyre angazhohet një personel akademik i përbërë nga 82 pedagogë, nga të cilët 52 të brendshëm (29 me grada e tituj) dhe 30 të jashtëm( 9 me tituj grada).

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 programi MP në Marketing me profile zhvillohet në variantin me 60 ETC i shtirë gjatë 1 viti kalendarik.Stafi akademik i angazhuar per programin e studimit në vitin aktual akademik **2017-2018** është **10** pedagogë gjithsej, nga të cilët **9** (PAE) dhe **1** (PAK).

Për vitin akademik **2016-2017** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **9** pedagogë gjithsej, nga të cilët **9** kanë qenë PAE, **9** me tituj/grada dhe **0** PAK.

Për vitin akademik **2015-2016** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **10** pedagogë gjithsej, nga te cilet **8** kanë qenë PAE, **8** me tituj/grada dhe **2** PAK **2** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2014-2015** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **11** pedagogë gjithsej, nga te cilet **9** kanë qenë PAE, **7** me tituj/grada dhe **2** PAK, **2** me tituj/grada.

Për vitin akademik **2013-2014** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **10** pedagogë gjithsej, nga te cilet **7** kanë qenë PAE, **5** me tituj/grada dhe **3** PAK, **3** me tituj/grada

Për vitin akademik **2012-2013** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **9** pedagogë gjithsej, nga te cilet **6** kanë qenë PAE, **4** me tituj/grada dhe **3** PAK, **3** me tituj/grada

Për vitin akademik **2011-2012** personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka qenë **10** pedagogë gjithsej, nga te cilet **7** kanë qenë PAE, **4** me tituj/grada dhe **3** PAK, **3** me tituj/grada.

Raporti Personel Akademik / Student në këtë program studimi per vitin akademik aktual është **10/29**, ndërsa për vitin akademik **2016-2017** është **9/40**

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është **9/1**, ndersa per vitin akademik **2016-2017** eshte **9/0**

Raporti PAE/Totalit te personelit akademik në këtë program per vitin akademik aktual është **9/10 = 90%**, ndersa per vitin akademik 2016-2017 eshte **9/9 = 100%**

Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re ky program studimi për vitin akademik aktual mbulohet rrith **90 % nga staf i brendshëm PAE** dhe rrith **10% staf i jashtëm, PAK.**

(Të dhënat e mësiprme janë bazuar në dokumentacionin e DVV)

#### **Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit**

Në mbështetje të mbarëvajtjes së programit të studimit funksionon Këshilli Shkencor i Programit të studimit i përbërë nga tre pedagogë me tituj nga të cilët një është koordinatori, Prof. Asoc. Dr. Oltjana Zoto, ish përgjegjësja e departamentit dhe dy anëtarë Prof. Dr. Drita Kruja, përgjegjëse e grup-lëndëve të marketingut dhe Prof. Assoc. Dr. Ermira Qosja përgjegjëse e grup-lëndëve të manaxhimit siç tregohet në **tabelën 4 aneksi 2**.

- Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre, jepen (Tabela 5 në aneksin 2)**
- Të dhënat sipas gjinisë jepen në (Tabelën 6 në aneksin 2) për stafin akademik të programit të studimit MP Marketing ku vërehet që raporti F/M është në favor të femrave.**
- Të dhëna sipas moshës së personelit**

Përsa i përket shpërndarjes së stafit akademik dhe administrativ të këtij programi studimi sipas moshës vërejmë se 100% e personelit mësimdhënës dhe rrith 90% e personelit administrativ janë të moshës 25-55 vjeç. (**Tabela 7 në aneksin 2**).

- Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat**

Nga vizita në institucion si dhe nga shqyrtimi i materialeve të DVV pamë se kontratat e punës ishin plotësuar me të gjitha seksionet respektive me të drejtat dhe detyrat e punonjësve sipas procedurave ligjore. Ato kanë të përshkruar detyrimet dhe të drejtat e secilës palë që e nënshkruan. Ne u njohëm me kontratën tip të punësimit si dhe vlerësuam me zgjedhje disa kontrata individuale të stafit akademik dhe mbështetës, në dy sistemet, full time dhe part time. Këto kontrata ishin konform legjislacionit të punës. Personeli kishte njohuri mbi të drejtat dhe detyrat që lindin nga zbatimi i kontratës, si dhe rastet kur pedagogu i brendshëm apo i jashtëm kishte angazhime të tjera jashtë UET-it

- Cilësia e stafit ndihmës/administrativ për çdo njësi bazë**

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se institucioni ka një staf ndihmës dhe administrativ cilësor për zhvillimin e programit të studimit. Kështu, stafi i Zyrës së IT-së, i angazhuar për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimit. Pranë UET gjendet një personeli administrativ gjithmonë i gatshëm në shërbim të studentëve dhe personelit akademik për të siguruar mbarëvajtjen e procesit akademik. Në UET funksionon Zyra e Karrierës, e cila siguron bashkëpunime më shumë institucione publike dhe kompani private dhe mban komunikim të vazhdueshëm me ta, për të siguruar zhvillimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen përmbytjen e objektivave të programeve të studimeve.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përpunje me objektivat e programeve të studimeve dhe përrritjen e tyre;	Bazuar në objektivat e programit MP në Marketing me profile, vërehet angazhim serioz i personelit akademik përmbytjen e tyre. Në syllabuset e miratuara të këtij programi janë shprehur qartë objektivat e mësimdhënies si dhe temat përkatëse për secilën prej moduleve të miratuara. Programi zbatohet tërësisht dhe
<b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në	

përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	ka një kordinim të personelit akademik me atë ndihmës dhe administrative. Personeli akademik dhe administrativ është i informuar për objektivat e programeve të studimit dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit, përmes një dokumentacioni të gjërë rregulator.
---	---

#### **Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.**

**Kriteri 1** Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;

**Kriteri 2** Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Gjatë takimit me personelin akademik si dhe dokumentat e siguruara në institucion tregojnë që në UET, personeli akademik luan një rol të rëndësishëm në hartimin e kurrikulave dhe vendimet për organizimin e programeve të studimeve. Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të departamentit

Kurrikulat e programeve diskutohen gjërësisht në mbledhjet e Departamentit ku ftohen edhe antarë të Bordit të Tregut të Punës. Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim të njësive bazë, departamenteve. Çdo anëtar i departamentit ka të drejtë të bëjë propozime dhe të argumentojë përpëra kolegëve ndryshimet e propozuara. Nëse vendimi miratohet në nivel departamenti kalon për miratim në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik.

UET-ja ka një kuadër rregullativ të brendshëm mbi të cilin mbështetet procesi i punësimit të personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme.

Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Ne verifikuam me zgjedhje të rastësishme disa praktika rekrutimi të personelit akademik dhe vlerësojmë zbatimin e kuadrit rregullativ të brendshëm të UET-së. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe në Zyrën e Arkivit gjenden dosje të aplikantëve për punë, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë. Personeli i angazhuar në programet e ciklit të dytë realizon ngarkesën mësimore sipas akteve në fuqi dhe kontratës së lidhur me UET-in

#### **Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.**


**Kriteri 1** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;

**Kriteri 2** Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruese të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;

**Kriteri 3** Institucioni ndjek procedura ligjore dhe

Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoti se UET ndjek politika të rekrutimit të personelit akademik në përputhje me praktikat ligjore dhe transparente për rekrutimin e stafit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme. Kriteret shpallen publikisht duke ofruar transparencen në treg. Vlerësimi i kandidatëve për punësim realizohet me system pikëzimi dhe nëpërmjet konkurrimit.

Nëse shohim evolucioni gjatë viteve të fundit lidhur me rolin në mësimdhënie të PAE dhe PAK, vemë re prirjen drejt përballimit të ngarkesës akademike me PAE gati



transparente të vlerësimit të personelit;  <b>Kriteri 4</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve përvende vakante, etj.	<p>në 100% konkretisht per tre viteit e fundit;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Për vitin <b>2015-2016</b> rezulton se <b>80%</b> e programit është mbuluar nga PAE</li> <li>• Për vitin <b>2016-2017</b> rezulton se <b>100%</b> e programit është mbuluar nga PAE</li> <li>• Për vitin <b>2017-2018</b> rezulton se <b>90%</b> e programit është mbuluar nga PAE</li> </ul> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ verifikoi se vlerësimi i personelit akademik realizohet në mënyrë periodike nëpërmjet 3 mënyrave:</p> <p>Vlerësimi nga përgjegjësi i departamentit, Vlerësimi nga studentët, nëpërmjet pyetesorit on – line dhe vlerësimit me Fokus Grupe Vlerësimi nga kolegët dhe nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up). Rezultatet pasi u komunikohen pedagogjeve, vendosen në dosjen personale në zyrën e burimeve njerëzore. Në Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Arkivit gjenden dosje të aplikantëve përvitës, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe të njoftimeve përvitës.</p>
--	---

### Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p><b>Kriteri 1</b> Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asocuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni siguron personel të mjaftueshëm përvitësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>	<p>Aktualisht përgjegjësi i programit të studimit ka gradën Prof. Asoc. Dr. me përvojë akademike edhe profesionale në këtë fushë.</p> <p>Nga verifikimi i dokumentave që këruam gjatë vizitës ne institucion rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve të programit të studimeve Master në Marketing janë të gjithë pedagogë me grada dhe tituj në përputhje me standardin.</p> <p>Programi i MP Marketing realizohet plotësisht me pedagogë të brendshëm të Fakultetit Ekonomik &amp; IT me përvojë akademike.</p> <p>Drejtuesit si rektori, zv/rektori, dekani, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i programit etj. janë të punësuar me kohë të plotë në UET në bazë të kontratës së punës të lidhur mes palëve.</p> <p>Stafi akademik i angazhuar ne kete program studimi ne vitin aktual ka një numër total prej 10 pedagogësh bazuar në raportin studentë/staf akademik që është <b>10/29 = 3</b> student, që duhet të mbikqyr një pedagog, rezulton se UET ka një personel të mjaftueshëm përvitësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p>
--	--

### Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës përvitës.

<p><b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës përvitës përvitësuar me kohë të plotë, që përgatisin përvitësuar me kohë të plotë;</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion rezultoi se të gjithë studentët që ndjekin këtë program studimi, në fund të semestrit të dytë mbrojnë një punim diplome.</p>
--	--

<p>studimeve të këtij cikli;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";</p> <p><b>Kriteri 3</b> Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	<p>Udhëheqësi i tezave është gjithmonë një pedagog me grade dhe titull, i cili krahas takimeve të personalizuara, zhvillon edhe seanca metodologjike në auditor me grupin e studentëve që udhëheq, për të garantuar një mbarëvajtje të procesit të shkrimit të punimit. Vihet re se pedagogët e departamentit të Menaxhim &amp; Marketing (të brendshëm) udhëheqin një numër studentësh më të lartë sesa kriteret dhe standarde vendosura. Ky është një tregues që duhet të përmirësohet, duke shtuar numrin e personelit të brendshëm akademik.</p>
<p><b>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p><b>Kriteri 2</b> Udhëheqësi ka njojuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Departamenti gjatë shqyrtimit të propozimeve të studentëve për temën e tezës master garanton që udhëheqësi i propozuar nga studenti të jetë në përputhje me fushën e programit të studimit dhe temën e propozuar.</p> <p>Nëse nuk ka pedagogë të brendshëm të përshtatshëm për të udhëhequr një temë të caktuar, atëherë departamenti cakton në pedagog të jashtëm brenda kritereve të këruara.</p>
<p><b>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe përmirëbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Nga shqyrtimi i materialeve të GVB dhe nga vizita në institucion shohim se personeli ndihmës mësimor-shkencor në UET është i angazhuar në realizimin e orëve laboratorike dhe në mirëbatjen e laboratorëve dhe mjediseve.</p> <p>Institucioni kujdeset për përdorimin optimal të burimeve njerëzore në funksion të realizimit të objektivave të programit, duke vendosur standarde për shpërndarjen e ngarkesës mësimore, dhe balancimin mes mësimdhënies dhe detyrave të tjera të personelit akademik.</p>
<p><b>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimit i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Ngarkesa mësimore e personelit akademik angazhuar në programin Master profesional në Marketing realizohet sipas kontratave të lidhura me UET, që përpilohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p> <p>Ngarkesa mësimore si dhe proceset e tjera akademike si udhëheqjet e diplomave, oponencat, mbikëqyrjet e praktikave profesionale, realizuar nga personeli akademik, vlerësohen me orë mësimore.</p> <p>Për ngarkesën e stafit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2017-2018, në dokumentacionin e sjellë nga institucioni rezulton:</p> <p>Stafi PAE: 1 pedagog mbulon 5 lëndë, 5 pedagogë mbulojnë 4 lëndë, 2 pedagogë mbulojnë 3 lëndë, dhe 1 pedagog mbulon 2 lëndë. Ngarkesa orë në auditor paraqitet: nga 138.25 deri në 262.5.</p> <p>Stafi PAK: 1 pedagog mbulon 1 lëndë.</p>

### **Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;

**Kriteri 2** Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;

**Kriteri 3** Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.

Bazuar në dokumentat bazë të funksionimit të UET, departamentet për programet dhe lëndët që menaxhojnë si dhe Zyra e Burimeve Njerëzore në nivel institucioni, mbajnë të dhëna të plota dhe të hollësishme në lidhje me personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie, formën e punësimit dhe ngarkesën që mbulon cdo pedagog.

Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ, për secilin semestër.

Kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik përcaktohen me dokument të veçantë, pjesë e broshurës së dokumenteve UET dhe publikohen në faqen e internetit dhe media sa herë që ka shpalje të vendeve vakante

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit, i cili angazhohet për përbushjen e objektivave të programit të studimeve Master Profesional në Marketing.

Personeli akademik i angazhuar në realizimin e programit të studimit në masën 90% është me kohë të plotë.

Përgjegjësi i programit është me titull “Prof. Assoc. Dr” dhe ka një përvjoje të gjatë akademike.

Titullarët dhe pedagogët e lëndëve të programit të studimeve Master në Marketing janë me grada shkencore në përputhje me standardin. Drejtuesit kryesorë të institucionit janë të punësuar me kohë të plotë.

UET ka një personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

Rol të rëndësishëm në mbështetjen e mirëorganizimit të procesit mësimor ka edhe personeli administrativ.

GVJ arriti në konkluzionin se standartet e kësaj rubrike **plotësohen plotësisht**.

#### ***Rekomandim:***

*Të tregohet kujdes në numrin e udhëheqjeve nga pedagogët e brendshëm të departamentit Menaxhim dhe Marketing, që është më i lartë sesa kriteret e standardeve vendosura, tregues ky që mund të përmirësohet me angazhimin e pedagogëve të jashtëm, specialistë të fushave përkatëse.*

### **4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit**


#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** mjediset, infrastruktura, teknologjite e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UET-ja vazhdon të zhvillojë veprimtarinë e saj në të njëjtën vendndodhje ku edhe ka nisur aktivitetin para 10 vitesh. Vendndodhja e UET është në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 70, H1, Tiranë. Për zhvillimin e veprimtarisë universitare, ai zotëron një sipërfaqe ndërtimi totale prej rrëth 10,000 m<sup>2</sup>. Godinat e tij kanë përrëth një hapësirë e gjerë për lulishte me stola të jashtëm, si dhe vend për parkim për rrëth 120 makina. Ato janë të pajisura me dy palë shkallë, për të përballuar rastet e emergjencës si dhe janë të pajisura me mjetet e nevojshme për mbrojtjen kundra zjarrit si: një fikse zjarri në çdo kat, dhe nga një fikse zjarri në burime potenciale zjarri, në total 30 copë, si dhe sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike, rrufe-pritëse.

UET garanton burime alternative për furnizimin me energji elektrike si dhe ka rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm. Mjediset janë të kompletuara me sistem ngrohës me komandim qendror, që funksionon pa ndërprerje dhe ku, janë certifikuar mirëmbajtje të rregullta të tij nga firma instaluese.

Në dispozicion të procesit universitar, UET ka tre godina: **Godina A** është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>, **Godina B** është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup> dhe **Godina C (biblioteka)** gjithsej 300 m<sup>2</sup>, sipërfaqe këto të ndara në: sala leksionesh,



gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale  $1510m^2$  dhe 1515 vende, salla seminari gjithsej 14, me sipërfaqe  $45m^2$  dhe secila me nga 35 karrige, salla 70 vendeshe (leksione + seminare) gjithsej 9 salla me sipërfaqe  $100m^2$  secila, salla për departamentet gjithsej 8 mjedise me sipërfaqe  $45m^2$  secila, zyra për përgjegjës departamenti gjithsej 8 mjedise me nga  $18m^2$ , zyra për kordinatorët gjithsej 6 mjedise me nga  $14m^2$ , 3 salla për laborator informatike me sipërfaqe  $45m^2$  secila me kapacitet 35 vende, sallë interneti me sipërfaqe  $165m^2$  me 80 kompjutera, zyra për pedagogët 30 me sipërfaqe  $14m^2$  secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe  $150m^2$ , me 32 vende pune, salla për bibliotekën me sipërfaqe  $300m^2$ , 150 vende leximi, mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe  $150m^2$ , zyra e informacioni për studentët 2, korridore dhe holle gjithsej 8 me  $150m^2$  secili, mjedis çlodhës për kafe/fast-food/etj me sipërfaqe  $500m^2$ , nyje hidrosanitare gjithsej 48 me sipërfaqe  $300m^2$ , zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarin 5 me nga  $20m^2$ , zyra për sekretarinë mesimore 3 me sipërfaqe  $140m^2$ , zyra për stafin akademik dhe administrativ 12 me sipërfaqe  $350m^2$ , mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore 3 me sipërfaqe  $140m^2$ .

Gjithashtu UET ka në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, si laboratori 205 B me 25 PC dhe video projektor, ai 206 B me 35 PC dhe video projektor, 207 B me 35 PC dhe video projektor, 208 B me 80 PC dhe 33 salla mësimore, të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore dhe foni. Biblioteka gjithashtu është e pajisur me PC dhe mjediset universitare janë të mbuluara me sinjal WiFi. Të gjitha klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive të nevojshme për zhvillimin normal të procesit mësimor, këtu përfshihen projektorët dhe sistemi i fonisë. Sistemet e operimit janë të gjithë Windows 7, me paketa Microsoft Office 2016 me të gjithë softëarët e saj: Access; Communicator; Excel; InfoPath; OneNote; Outlook; PoëerPoint; Publisher; SharePoint Ëorkspace dhe Word. Laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Mirëmbajtja e pajisjeve kompjuterike bëhet nga stafi i Zyrës së Teknologjisë së Informacionit. dhe instalimet e programeve dhe azhornimet e tyre bëhen në kohë reale. Programet kompjuterike iu janë përshtatur programeve mësimore duke instaluar programet aplikative që kërkohen nga departamentet përkatëse mësimore. Në UET funksionojnë sisteme që mbështesin studentin në procesin mësimor, si sistemi MOODLE (UET LMS), i cili bën të mundur që studenti të azhornohet me materialet e hedhura nga pedogogu në kohë reale dhe të komunikoje nëpërmjet sistemit në forume të hapura me pedagogët si dhe kolegët e kursit që ndjek, të shikojë notat dhe pikët online nga kudo që ndodhet. UET disponon bibliotekën, ku, pasurimi i fondit të saj bëhet përmes: blerjeve në fillim të çdo fillim viti akademik i një numri të konsiderueshëm tekstesh universitare dhe librash të reja që janë pjesë e kurrikulave shkolllore si tekstet bazë ose si literaturë e rekomanduar; blerjeve në Panairin Kombëtar të Librit në nëntor të çdo viti i botimeve më të rëndësishme që lidhen drejtpërsëdrejti apo tërthorazi me procesin mësimor në të tre fakultetet e UET; përkthimit dhe botimit nga UET Press i shumë teksteve, që kanë për autorë pedagogë të UET, studiues të tjera shqiptarë dhe autorë të huaj, klasikë dhe bashkëkohore si dhe koleksionet e plota të të gjitha revistave shkencore që botohen nga UET; porosive dhe blerjeve online në Amazon.com e dhjetra apo qindra botimeve të rëndësishme dhe nga më të fundit në gjuhën angleze në ato fusha të shkencës me të cilat identifikohet me së miri ekspertiza e UET. Gjithashtu janë kryer abonime në biblioteka virtuale, dhe revista shkencore në hard copy, të cilat ofrojnë për studentët dhe stafin akademik mijëra tituj librash dhe artikuj shkencorë bashkëkohorë, ku mund të përmenden: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia; dhe revistat shkencore të huaja: Harvard Business Review, The Economist, Foreign Affairs, Commentaire, The Nations Interest, The American Interest, Educational Leadership etc. Në bibliotekë janë instaluar 14 PC. Në fondin e Bibliotekës së UET ka tituj të botuara nga UET-Press, të autorëve shqiptarë ose përkthime nga UET Press. Biblioteka ka një staf të kualifikuar në ndihmë të studentëve si edhe për shërbime të tjera bibliotekare.

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

- Mjediset për Programin e studimit,stafin**

Të dhënat për mjediset ku zhvillohet programi Master në Marketing të tilla si: salla për leksione, klasa për seminare, salla për aktivitete promovuese, salla për praktikë lëndore ose profesionale, laboratorë për lëndët, laboratorë informatike, salla interneti, salla për bibliotekë, mjedis për fotokopjime, librari etj. zyrë informacioni për studentët dhe nyje hidrosanitare jepen në **tabelën 8** në aneksin 3

### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni ka një vendndodhje të përherershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimitaria mësimore;	Institucioni ka një vendndodhje të përshtatshmë si të mjedisit qendror administrativ ashtu edhe të mjedisit ku zhvillohet veprimitaria mësimore. UET ndodhet në Blv. Gjergj Fishta që prej shtatorit 2007. Sipërfaqja totale e godinave të Universitetit është rreth 10,000 m <sup>2</sup> . Kjo e bën infrastrukturën e UET të bollshme dhe shumë komode. Programi i studimit realizohet në një godinë dhe është nën kontroll të vazhdueshëm nga institucioni për arritjen e standardeve.
<b>Kriteri 2</b> Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Zhvillimi i procesit mësimor te programit realizohet ne dy godinat A dhe B që ndodhen pranë njëra-tjetrës. Gjithashtu për një shfrytëzim optimal të infrastrukturës në dispozicion, mësimi në ciklin e dytë të studimeve zhvillohet kryesisht nga e mërkura në të premte, 17:00-20:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00.
<b>Kriteri 3</b> Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;	Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.
<b>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;	Për realizimin e këtij programi UET siguron tekste mësimore cilësore, që përcaktohen në silabuset e çdo lende. Biblioteka disponon: 6167 tituj në total nga të cilët: 6005 janë tituj librash dhe 162 janë tituj periodikësh e revistash. Ndër titujt e librave, 4734 janë tituj në gjuhën shqipe dhe 1371 janë tituj në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht, gjermanisht).
<b>Kriteri 2</b> Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për përfundimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Ndër titujt e revistave dhe periodikëve, 102 tituj janë në gjuhën shqipe dhe 60 tituj janë në gjuhë të huaj (anglisht, frengjisht, italisht).
<b>Kriteri 3</b> Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme përfundimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;	Nga vizita pranë bibliotekës se UET rezulton qe hapësira e saj është optimale me rreth 150 vende leximi. dhe 8 kompjutera për punime dhe kërkime shkencore.
<b>Kriteri 4</b> Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar përfundimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar përfundim;	Biblioteka ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike përfundimin e artikujt dhe libra shkencore si: EBCSO, Emerald, Cambridge University, Taylor & Francis, Questia, Etj.
<b>Kriteri 5</b> Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.	Orari i Bibliotekës është përshtatur sipas programeve të studimit që fillon: e Hene- e Premte 9:00-20:00 dhe e Shtunë 9:00-17:00. Kurse gjatë sezonit të provimeve është me orar të zgjatur.
<b>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise përshtatshme mësimore.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Laboratorët përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>UET ka aktualisht në përdorim 3 laboratorë mësimorë informatike, të cilët janë të pajisuar me PC, video projektor dhe mjete audio vizive, të cilat janë të përshtatshme për numrin e studentëve që i përdorin ato. Të gjitha sallat mësimore janë të pajisura me PC dhe mjete audio vizive të cilat vijnë në ndihmë si studentëve ashtu edhe stafit akademik. Ambjentet universitare janë të mbuluara me sinjal Wi-Fi internet në mënyrë që studentët të aksesojnë webin. Pajisjet dhe programet e instaluar janë risitë e kohës në fushën e teknologjisë së informacionit. Të gjithë laboratorët janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Në PC-të e laboratorëve janë instaluar programet kompjuterike sipas kërkesave të programeve të studimit, dhe lëndëve specifike.</p> <p>Bazuar në infrastrukturën që ka specifikuar GVB nëpërmjet tabelave dhe përshkrimeve dhe nga konstatimet tona nga vizita që bëmë në institucion, vlerësojmë se UET i plotëson të gjitha kriteret e këtij standardi.</p>
---	--

### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Mjediset e zhvillimit të veprimtarisë së institucionit dhe programit MP në Marketing me profile janë te përshtatshme dhe funksionale për zhvillimin normal të procesit mësimor, me sistem kondicionimi dhe sistem wireless. Sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri dhe me sistem fonie. Çdo sallë mësimore është e pajisur me PC dhe projektor.

Laboratorët e informatikës janë të pajisur me programet e nevojshme të përcaktuara në programin mësimor. Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira dhe një fond të pasur botimesh hard copy dhe elektronike, në gjuhën shqip dhe gjuhë të huaja, për të mbështetur studentët dhe personelin akademik në punën e tyre studimore dhe kërkimore shkencore. Personeli akademik i brendshëm është i akomoduar në zyra dyshe. Përgjegjësit e departamenteve, dekanët, zv. Rektorët dhe drejtuesit e tjerë janë akomoduar në zyra individuale. Në dispozicion të departamenteve janë edhe sallat e mbledhjeve. Çdo zyrë është e pajisur me PC përkatës për secilin pedagog.

GVJ arriti në konkluzionin se të gjitha standardet e kësaj rubrike **plotësohen plotësisht**.

## **5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare është një komponent i rëndësishëm që siguron mbarëvajtjen e procesit mësimor. Burim kryesor financimi janë tarifat për dhe gjatë shkollimit si dhe te ardhura te siguruara nga aktivitetet tregtare. Për vitet 2013-2016 një element tjetër që ka kontribuar në burimet financiare të UET, janë edhe grantet për kërkim dhe kontratat (qeradhenie, parkim etj.) Nje zhvillim pozitiv ne kete drejtim gjate 3-4 vitet e fundit janë burime financiare te siguruara nepermjet kontributeve dhe granteve për kërkim dhe kontratat ne kuader te projekteve ku institucioni eshte pjesemarres dhe perfitues

Universiteti European i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit. UET shpk përbush kuartat për kryerjen e një ekspertize, çdo vit hartohet një raport në lidhje me transparencën financiare. Per pasqyrat financiare te çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor ka dhene opinionin ne lidhje

me pozicionin financiar, performancen dhe perputhjen me standartet e kerkura te kontabilitetit. Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjithadrejtimet aspektet materiale, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur .

#### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

##### **Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje):**

Të ardhurat dhe financimet e këtij programi studimi vijnë nga grantet për kërkim, konsulencat, shërbimet, tarifat e shkollimit, sponsorizimet, shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm), donacionet, aktivitetet siguruese, fondacione etj., aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj). Disa të dhëna lidhut me të ardhurat dhe financimet e këtij program studimi për periudhën 2011-2016 janë pasqyruar në **tabelën 9 në aneksin 3**. Nga tabela vërehet se financimet që nga viti 2011 për çdo vit janë në rritje respektivisht në masën 101%, 110%, 100.5%, 118.5%, dhe 105.7%. Më e dukshme është rritja për vitet 2015 dhe 2016 ku kontribut më të madh kanë grantet për kërkim dhe aktivitetet tregtare. Çdo vit në muajin korrik UET harton projektin financiar, i cili miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili dhe për zbatimin e tij, ngarkohet Zv.Administratori dhe Zyra e Financës. Për çdo veprim blerje dhe shitje, zyra e financës lëshon një "Kërkësë për Lëvrim fondesh", të miratuar nga Zv.Administratori. për çdo veprim bëhen fatura të rregullta tatimore dhe lëvizjet e parave bëhen me bankë. Projekt buxheti hartohej në mënyrë të tillë, që shpenzimet të mbulohen në vazhdimësi, për çdo student deri në diplomimin e tij. UET kryen kontroll dhe audit çdo vit, dhe çdo vit hartohej një raport në lidhje me transparencën financiare. Për pasqyrat financiare të çdo viti audituesi i pavarur ose audituesi ligjor jep opinionin e tij në lidhje me pozicionin financiar, performancën dhe përputhje me standartet e kerkura të kontabilitetit.

##### **Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje)**

Të dhënat për shpenzimet në lekë për një studentët, për studentët, që ndjekin programet e studimit janë dhënë për tre vitet e fundit akademike dhe 2014-2015, 2015-2016 dhe 2016-2017 dhe pasqyrohen në **tabelën 9.1 në aneksin 4**. Nga tabela vërehet se për vitin akademik 2015-2016 kemi rënje të kostos për student në masën 93.8%, pasi ka një rritje të numrit të studentëve afërsisht 121 % nga një vit më parë. Ndërsa për vitin akademik 2016-2017 kemi rritje të kostos për student në masën 110.5%, pasi ka rënje të numrit të studentëve në masën afërsisht 98%, afërsisht nga një vit më parë.

Theksojmë se në këtë pikë nga GVB duhet të bëhej një analizë e detajuar lidhur me elementet përbërëse, që përcaktojnë koston për një student të programit të studimit Master Profesional në Marketing.

#### **Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.</b>	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë; dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	UET ka raport auditit çdo vit, të cilat shqyrtojnë situatën financiare në lidhje me përputhshmërinë e shpenzimeve dhe investimeve të kryera.
Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituarë dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	Raportet janë transparente në lidhje me kontabilizimin e të ardhurave nga të gjitha mënyrat dhe të shpenzimeve, si dhe kategorizimin e tyre në llogaritë përkatese.
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit	Raportet audituese kanë si qëllim të sigurojnë që UET procedon në mënyrë të tillë, që të arrijë: a) eficencën dhe efikasitetin operacional; b) besueshmërinë e raportimit financiar dhe

të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.	menaxherial; c) pajtueshmërinë me politikat dhe rregulloret e tij, të cilat mundësojnë rritjen e cilësisë në ciklet përkatëse të studimeve
---	--

### **Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport finanziar të kostove të programeve të studimeve.**

**Kriteri 1** Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fiksë të malediseve dhe të pajisjeve, etj.

**Kriteri 2** Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.

Për secilin vit akademik institucioni përgatit një analizë të detajuar të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si ato operative ashtu edhe fiksë të malediseve dhe të pajisjeve, etj, përshkrimi më i hollësishëm i të cilave mungon në materialin e përgatitur nga GVB.

UET ka kapacitete të mjaftueshme financiare për situata pozitive financiare gjithnjë në rritje sikurse dhe qëndrueshmeri financiare sikurse paraqitet edhe më sipër.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

Analizat sistematike të eficencës dhe e kostove financiare sikurse dhe auditimet e jashtme dhe të brendshme mundësojnë UET në marrjen e vendimeve optimale manaxheriale për të siguruar stabilitet dhe vijueshmëri financiare për ofrimin e programeve të tij të studimit.

Vlerësojmë menaxhimin akademik në harmoni me eficiencën financiare dhe rigorozitetin e standardeve cilësiore në kushtet e “tregut” specifik të edukimit të Lartë në Shqipëri.

Sygjerojmë që të dhënat mbi koston për student të plotësohen me një analizë të detajuar lidhur me elementet përbërëse që përcaktojnë koston për një student.

Nga shqyrtimi i materialeve të DVV dhe nga kontaktet në institucion, GVJ konkludoi se financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare plotëson plotësisht standardet e kërkua.

## **6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritura e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë që nga Janari i vitit 2011 është institucionalizuar si strukturë organizative në UET nëpërmjet ngritjes dhe operimit te njësisë së përhereshme; Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar një veprimtari sipas dispozitave të legislacionit në fuqi, statutit dhe akteve të tjera të brendshme rregullatore si dhe objektivave strategjike të vendosura në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. Në funksion të sigurimit të cilësisë, për secilin program lende që është pjesë e programeve të studimit, UET ka konceptuar një format standard, ku theksi është vendosur në paraqitjen e detajuar të çështjeve që do të mbulojnë temat që trajton lënda, si dhe të literaturës përkatëse, të detyrueshme dhe plotësuese. Literatura përzgjidhet pas një konsultimi të gjerë me ekspertë të fushës përkatëse dhe diskutimit sipas grup-lëndëve dhe në departament.

Gjithashtu, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënies online. LMS është një aplikacion web për administrimin, dokumentimin, ndjekjen, raportimin dhe shpërndarjen e materialeve mësimore dhe informacionit tjetër të rendësishëm për studentët. Ky sistem ofron informacion të personalizuar për çdo përdorues të student apo pedagog. Çdo student, apo pedagog që hyn në sistem, merr vetëm informacionin që i përket atij. Funksioni kryesor i këtij sistemi është të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e materialeve të studimit dhe informacionit (njoftimet detyrat që duhen dorëzuar, afatet e dorëzimit, etj.) mes pedagogut dhe studentëve, duke ndihmuar në rritjen e cilësisë së mësimnxënies,



pasi studenti merr përmes sistemit, gjithë bazën didaktike dhe orientimet e pedagogut për lëndën, si edhe ka mundësi t'i drejtojë atij pyetje për paqartësitë e mundshme. Njëkohësisht, ai është edhe një mjet eficent në dispozicion të KSBC-së për të monitoruar mbarëvajtjen e procesit të akademik, përmes të dhënave statistikore të gjeneruara nga ky sistem.

Në takimin e realizuar me antare te kesaj njësie doli që fokusi i KSBC-së është edhe:

- Formatizimi i syllabuseve (nga ana teknike)
- Monitorimi i zhvillimit të provimeve
- Kërkimi shkencor, aktivitetet që zhvillon stafi akademik, botimet, trajnimet
- Monitorimi i përbushjes së standardeve në tërësi

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:**

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm
- Etj.

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve ad hoc, dhe që nga janari 2011 në formën e një njësie të përherëshme në strukturën organizative të institucionit. E cila përbëhet nga kryetari dhe 10 anëtar, dhe në përbërjen e saj ka përfaqësues nga të gjitha fakultetet dhe nga studentët (**shih tabelën 10 në aneksin 5**) Komisioni vlerëson periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e financiare të UET dhe ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Kjo njësi dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët, shpërndan pyetësorë online tek studentët për vlerësimin e performancës së pedagogëve, të cilat pastaj përpunojnë po nga kjo njësi. Gjithashtu ajo monitoron dhe përpunon rezultatet e formave të tjera të kontrolleve horizontale si vlerësime koleg-për-kolegun dhe vertikale vlerësime nga drejtuesit Një formë tjetër e sigurimit të cilësisë është dhe kontrolli i provimeve të ndërmjeteme dhe atyre të semestrit. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilit pasqyrohen në raportet përkatëse. Rezultatet e kontrolleve të formave të ndryshme të përpunuara nga kjo njësi, janë një burim i rëndësishëm informacionesh për të nxjerrë konkluzione mbi cilësinë e punës së secilit dhe në disa raste janë shoqëruar edhe me marrjen e masave konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm. Ndër problemet më kryesore kanë qënë lidhur me literaturën e rekomanduar, shfrytëzimin e orës së mësimit, cilësinë në shpjegim dhe kontrollin e dijeve, etj.

#### **Kontrolli i brendshëm i cilësisë**

Përveç formave të kontrollit të sipërpërmendura një ndikim të drejtëpërdrejtë në sigurimin e cilësisë jep edhe takimet e drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga "fokus grupet" si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik, ku tërhiqet mendimi i studentëve mbi çdo program studimor në tërësi, mbi çdo lëndë të veçantë dhe çdo pedagog. Të dhënat e fituara nga këta pyetësorë, pas përpunimit shfrytëzohen gjëresisht në mbështetje të procesit të follow up-it, gjatë të cilit drejtuesit e institucionit bëjnë vlerësimin e performancës akademike të secilit pedagog në përfundim të vitit akademik. Gjithashtu, përfshirja e ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit të brendshëm është konsideruar një përvojë shumë e mirë për të siguruar më shumë objektivitet dhe paanshmëri në gjykimet dhe rezultatet e vlerësimit, si edhe për të marrë feedback nga ekspertë të cilët mund të sjellin perspektiva e këndvështrime të ndryshme, për të përmirësuar më tej

praktikat e zbatuara. Ngritja e organeve këshilluese si Bordi i Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës e ndihmon institucionin për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET është përfshirë si partner në dy projekte europiane që kanë në fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë (projekti TEMPUS "ENCHASE" dhe Erasmus+: QAinAL). Angazhimi në këto projekte dhe trajnimet, i kanë shërbyer institucionit në përditësimin e praktikave të sigurimit të cilësisë

**Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti**

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë bien mbi njësinë e KSBC, veprimtarinë e së cilës zhvillohet e organizuar sipas një plani kalendar të përvitshëm të miratuar nga rektori, në të cilin programohen kontrolllet në sektorët apo proceset që i nënshtronen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse. Ndërkohë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET rreth rezultateve të kontolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

**Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre**

**Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike**

Mbi bazën e rezultateve të vetëvlerësimeve të realizuara periodikisht, institucioni ndjek politika të përmirësimit të cilësisë. Cilësia shpërblehet në UET, përmes nxitjeve monetare edhe morale, siç ndodh në rastet kur pedagugu fiton më shumë pikë në indikatorët e matjes së performancës, ai përfiton një shumë më të madhe nga granti kërkimor.

Një drejtim i rëndësishëm për sigurimin e brendshëm të cilësisë lidhet me trajnimin e pedagogëve, si për freskimin e njohurive të tyre mbi metodikën e mësididhënieve, si dhe njohjen e rregulloreve të brendëshme të UET. Kujdes më i veçantë i kushtohet trajnimit e pedagogëve të jashtëm, duke vënë theksin jo vetëm në njohjen e specifikave të rregulloreve të UET, por edhe në aspekte metodike dhe të organizimit të mësimit.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><b>Të tërthorta:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve;</li> <li>b. Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënieve, kurrikulës, të të mësuarit;</li> <li>c. Pyetje konceptuale;</li> </ul>	<p>KSBC, ështe struktura përgjegjëse për menaxhimin e vlerësimit për ecurinë e programeve të studimit Për secilin nga proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit akademik dhe rezultatet e tyre ajo raporton pranë rektoratit dhe dekanateve të fakulteteve. Vlerësimin e cilësisë së programit e prezanton nëpërmjet raporteve periodike pranë instancave vendimarrëse përkatëse më të larta si dhe pranë Departamentit.</p> <p>UET kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, për të gjitha lëndët dhe të gjithë pedagogët.</p> <p>Rezultatet e tyre i vë në dispozicion të</p>



<p>d. Intervista;</p> <p>e. Etj.</p> <p><u>Të drejtpërdrejtë:</u></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>a. Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj);</li> <li>b. Dëgjime në auditor;</li> <li>c. Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë;</li> <li>d. Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale;</li> <li>e. Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.);</li> <li>f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;</li> <li>g. Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</li> <li>h. Etj.</li> </ul>	<p>drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në vlerësimin e performancës së çdo pedagogu në përfundim të vitit akademik. Kujdes i kushtohet intervistave me studentët, si edhe ato me pedagogët gjatë shqyrtimit të performancës së tyre.</p> <p>Në mënyrë sistematike nga ana e sektorit të statistikave përpunohen të dhënët mbi rezultatet e studentëve në studimet e tyre në UET, kalueshmëria për lëndë dhe pedagog, etj.</p> <p>Për kryerjen e vlerësimit, përdoren metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejtë:</p> <p><u>Të tërthorta:</u> Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, Sondazhe vlerësimi të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista</p> <p><u>Të drejtpërdrejtë:</u> Teste të standardizuara, Dëgjime në auditor, Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët, Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p>
<p><b>Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni publikon rregullisht broshura, butelime etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>UET përgatit dhe shpërndan në formën e një raporti vlerësimet periodike mbi cilësinë, i cili u vihet në dispozicion drejtuesve, pedagogëve, si dhe aktorëve të tjera të interesuar.</p> <p>Këto raporte janë pjesë e diskutimeve në nivel rektori si dhe departamenti.</p>
<p><b>Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.</b></p> <p><b>Kriteri 1</b> Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>UET bën analiza vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e programeve të studimeve, duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.</p> <p>Bazuar në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës dhe të studentëve, institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë për të reflektuar zhvillimet bashkëkohore në aspektin teorik si dhe kërkesat e tregut të punës në aspektin praktik.</p>
<p><b>Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.</b></p>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni ka plotësuar standaret institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p><b>Kriteri 5</b> Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p><b>Kriteri 6</b> Institucioni harton dhe zbaton një strategji përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Në kuadër të plotësimit të standardeve institucionale UET është akredituar dhe riakredituar në nivel institucional. Programi i studimit i cili po riakreditohet është akredituar nga institucionet përgjegjëse. UET realizon sigurimin e cilësisë përmes instrumentave të tilla si përfshirja e personelit akademik dhe ndihmës, ushtrimit të kontrollit nga strukturat drejtuese dhe KSBC, tërheqja e mendimit të studentëve, të antarëve të Bordeve të Tregut të Punës etj. Për sigurimin e cilësinë UET harton politika, shqyrtion dhe miraton ato në Senatin Akademik dhe strukturat e tjera në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë. Për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, UET, përdor mekanizma të tillë si, organizimi i pyetësorëve me studentët aktualë dhe ata të diplomuar në UET, sistemi LMS, grupet e punës për probleme të veçanta, format e ndryshme të kontrollit etj. Ndërgjegjësimi i personelit bëhet përmes disa formave si trajnimi, rifreskimi i njohurive mbi standardet ej. Strategjia mbi sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë zbatohet përmes veprimtarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC dhe reflektohet në format standarde të publikura në intranetin e UET</p>
--	---

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET si Institucion i Arsimit të Lartë, sigurimin dhe plotësimin e standardeve të cilësisë e konsideron si prioritet për secilin punonjës e realizon këtë objektiv falë:

- përvjës akademike të stafit të tij,
- konsolidimit të veprimtarive të ndryshme lidhur me sigurimin e cilësisë dhe kulturën së tij, të monitorimit të sigurimit të cilësisë në veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor.
- hartimit dhe publikimit të dokumenteve strategjike të bazuara në të dhënat që merren nga KSBC.
- përfshirjes në këto procese të ekspertëve të jashtëm si edhe duke u bërë pjesë e projekteve dhe trajnimeve europiane.

Nga shqyrtimi i standardeve të mësipërme GVJ arrin në konkluzionin se këto **standarde plotësohen plotësisht nga UET**.

## **POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE**

### **7. Programi i studimit, organizimi i tij**

#### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** misioni dhe objektivi i programit të studimit, përbajtja e programit, organizimi i vitiit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësish në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Misioni i UET është t'u japë studentëve një edukim cilësor, *duke përkthyer në të rezultatet e një kërkimi shkencor të vlefshëm*, t'i shërbejë dijes së shoqërisë shqiptare nëpërmjet mësimdhënies, kreativitetit, përdorimit të arritjeve më të mira të shkencës, si dhe ndërtimit të partneriteteve me tregun e punës e atyre ndërkombëtare. UET synon t'u ofrojë studentëve mundësi për të fituar një diplomë në nivelin Master Profesional në disa specializime, të cilët do t'u jalin atyre njohuritë, aftësitë dhe bësimin e duhur për të patur sukses në një mjesid pune të ndryshëm dhe t'i përgatisë ata për jetën si qytetarë të aftë të komunitetit botëror. Ai bashkërendon mësimin teorik me atë të aplikuar dhe të orientuar drejt ekonomisë së tregut duke vënë theksin në zhvillimin e vashdueshëm të tij si një institucion këkrimor-shkencor. UET angazhohet në mënyrë të vazhdueshme në zhvillimin intelektual dhe personal të studenteve të tij, duke u përpjekur të krijojë specialistë të marketingut me njohuri dhe ndërgjegje, që të arrijnë sukseset lokale dhe ndërkombëtare, në lidhje me strategjitet e tyre marketing. Programi synon që t'i bëjë studentët të zotë në diskutime teorike dhe aplikime praktike në fushën e marketingut, duke i pajisur ato me aftësi që të kuptojnë procesin e marketingut të organizatave, strategjitet marketing, menaxhimin e strategjive marketing, krijimin e një politike marketing, dhe sistemet e informacionit në lidhje me marrdhëniet me klietët. Programi i studimit është i organizuar në mënyrë të tillë që studenti të marrë formimin e duhur, për arritjen e objektivave profesionale sipas profilit të zgjedhur, me qëllim punësimin, ose kualifikimin në një drejtim të ngushtë. Programi i studimit Master Profesional synon ta pajisë studentin me: njohuritë teorike bazë të fushës së studimit, aftësitë praktike aplikative në profesionin përkatës dhe aftëstë për zhvillim karriere dhe integrim në tregun e punës. Programi i studimit Master Profesional në Marketing ofrohet me kohëzgjatje 1 vit akademik, me 60 kredite. Ai përbëhet nga 6 lëndë, praktika profesionale dhe punimi i diplomës dhe ofrohet me tre profile: Shërbime dhe Turizëm, Inovacion dhe Tregje Strategjike, Marketing Bankar dhe Financiar. Në këtë program studimi studenti merr 36 kredite përmes disiplinave formuese, 10 kredite përmes praktikës profesionale dhe 14 kredite për punimin e diplomës dhe duhet të realizojë së paku 1500 orë punë. Të gjitha lëndët e programit zhillohen sipas Tipologjisë II, pra në mënyrë interaktive me leksione dhe seminare të ndërthurura, nga lektorë me të paktën gradë doktor dhe të specializuar në fushat përkatëse. Ngarkesa është e balancuar mes semestrave dhe lëndët ndjekin një radhë që është e nevojshme për përvetësimin e tyre. Çdo lëndë ka syllabusin e vet, sipas standardit të UET. Syllabuset pasi miratohen u shpërndahen studentëve në fillim të zhvillimit të kurseve.

Pranimi i studentëve që do të ndjekin këtë program studimi bëhet në përputhje me kapacitetet e institucionit sipas disa kriterieve specifike akademike të vendosura nga Këshilli i Fakultetit. Këto kriteri bëhen publike për studentët para fillimit të aplikimeve për regjistrimë në këtë program studimi. Në fillim të çdo semestri studentit i vihet në dispozicion programi i çdo lënde që ofrohet. Këto programe depozitohen në librarinë e Universitetit, si dhe mund të publikohen në formën e një broshure nga UET.

#### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

##### Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi MP në Marketing me profile është licensuar me VKM Nr. 74, datë 21.01.2019 dhe akredituar me Urdhër Nr 68, datë 14.02.2011 si Masteri i Nivelit të Parë në Marketing me tre profile: 1. Shërbime dhe turizëm, 2. Inovacion dhe tregje strategjike, 3. Marketing bankar e financiar. Me ndryshimin e ligjit ky master është konvertuar në Master Profesional në Marketing me tre profile me kohë të plotë dhe me Urdhër Nr. 380, datë 12.10.2015, MAS ka bërë riregjistrimin formës së diplomës së tij, të lëshuar nga UET.

Programi Master Profesional në Marketing me tre profile në UET ka si qëllim që ti pajisë studentët me njohuri, aftësi, inteligencë dhe eksperiencë, që i ndihmojnë ata të hyjnë me sukses në botën e profesionaleve duke përdorur aftësitë e fituara në këtë program, mbi marketingun për kompani të ndryshme shërbimi, apo për të vazduar studime të mëtejshme pasuniversitare. Për këtë qëllim, kurikulat hartohen dhe modulet e tyre strukturohen mbështetur në eksperiencën akademike dhe profesionale të stafit akademik brenda dhe jashtë UET, si edhe në përvojat e të diplomuarve. Programi

u siguron studentëve mundësinë të bëhen pjesë e një studimi që kombinon teorinë dhe praktikën e marketingut për bizneset brenda dhe jashtë vendit. Duke u përpjekur të krijojë specialistë të Marketingut me njohuri në lidhje me strategjitet marketing në prfilet përkatëse, synimet e programit lidhen me objektiva për studentin si: të kuptojnë procesin e marketingut të organizatave, strategjitet marketing, menaxhimin e strategjive marketing, etj.; të bëhet aftësohen në aplikimin dhe interpretimin e strategjive marketing për biznesit lokal dhe ndërkombëtar; të bëhen të aftë në diskutime teorike dhe aplikime praktike në fushën e marketingut.

**Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)**

Programi Master Profesional në Marketing me tre profile, ofruar nga UET, zgjat 1 vit akademik me 2 semestra që ka 28 javë mësimore në auditor.:

- 1 vit akademik ka 28 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 14 javë mësimore në auditor
- 1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit
- 1 orë mësimore = 60'

**Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Referuar RVB plani mësimor i detajuar sipas numrit të lendeve dhe formave të mësimdhënies për semestër si dhe plani mësimor i ndarë sipas veprimtarive formuese nga (A-F) janë paraqitur në (**Tabelat 11 dhe 12 në Aneksin 6**)

**Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:**

Të gjithë lëndët që zhvillohen në këtë program studimi janë konceptuar me 6 kredite dhe ngarkesa orare sipas formave të studimit jepet si më poshtë:

Një ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit qe perfshin:

• Leksionet	11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
• Seminaret	7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit
• Projekt/detyra/ushtrime	12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
• Praktikën Profesionale	22 orë në auditor dhe 3 orë punë e pavarur e studentit
• Punim diplome	1.5 orë në auditor dhe 23.5 orë punë e pavarur e studentit

**Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara**

Në planin mësimor të këtij programi janë bërë disa ndryshime krahasuar me programin mësimore të licensuar. Kështu lënda Reklama dhe Promocioni nga lëndë e kategorisë (A) ka kaluar në lëndë e kategorinë (B) të programit dhe në kategorinë A është shtuar lënda "Metoda kërkimi të avancuara + Statistikë social". Lënda "Ekonomia dhe menaxhimi i novacioneve" nga lëndë e përbashkët në kategorinë (B), ka kaluar në lëndë e profitit "Inovacion dhe Tregje Strategjike" në vend të lëndës "Marketing ndërkombëtar". Lënda "MP Biznesi" që zhvillohej në profilin Shërbime dhe Turizëm është zëvendësuar me lëndën "Marketing Shërbimesh" Të gjitha ndryshimet e bëra nuk e kanë kaluar masën e lejuar 20%. (**Shih Tabelën 13, Aneksi 6**).

**Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës**

Ashtu sic e kemi trajtuar edhe më sipër, në zhvillimin e programit PAE kundrejt PAK gjatë 3 viteve të fundit ka mbuluar mbi 90 % të këtij programi.

Të dhëna më të detajuara jepen në Tabelën 14, Aneksi 6.

**Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.**

Syllabuset e të gjitha lëndëve të programit të studimit përmbajnë emërtimin e lëndës, në çdo syllabus shënohet viti dhe semestri kur do të zhvillohet lënda, si dhe emri i pedagogut që zhvillon lëndën. Gjithashtu në syllabuset shënohet vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit si dhe njohuritë dhe aftësitë që i jep studentit lënda.

Syllabuset janë të detajuara me tema që mundësojnë formimin teorik dhe praktik të studentit, ato përmbajnë ngarkesën në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe kreditet përkatëse. Të gjitha syllabuset përfshijnë: format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës, raportet midis tyre, format e vlerësimit të studentëve, detyrimet e studentit për lëndën, literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse

**Analizë e cilësisë së syllabuseve**

Vlerësojmë se syllabuset e lëndëve për zhvillimin e këtij programi janë ndërtuar konform rreullave me të gjitha elementet e duhura.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.</b> <b>Kriteri 1</b> Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS); <b>Kriteri 2</b> Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Programi MP ne Marketing me profile që ofrohet në UET është akredituar me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011. Programi eshte i organizuar në përputhje me udhëzimet e MAS dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Programi Master Profesional në Marketing ofrohet me kohë të plotë dhe gjatë një viti studenti grumbullon 60 kredite, të ndara në mënyrë të balancuar në dy semestra.
<b>Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</b> <b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukurë" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional; <b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukurë" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve; <b>Kriteri 4</b> Programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;	Nga shqyrtimi i materialeve të siguruara nga GVB programi i studimeve Master Professional në Marketing i pajis studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim të mirëfilltë profesional në fushën e marketingut, duke synuar të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve dhe duke u dhënë më shumë mundësi në tregun e punës. Programi i studimeve Master Professional në Marketing arrin ti pajisë studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale duke synuar të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij. Programi i studimeve Master Professional në Marketing ka objektiva të qarta profesionale, të justifikueshme, të arritshme, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të



<p><b>Kriteri 5</b> Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 6</b> Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukurë" dhe programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	
<p><b>Kriteri 7</b> Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	

#### **Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.**

<p><b>Kriteri 1</b> Përbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Programi në përbajtjen e tij ofron tiparet e një programi të nivelit të dytë ne fushën e marketingut. Programi ndërtohet mbi njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimit, dhe thellon njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përputhje me kriteret e vendosura.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Nga verifikimi që ne bëmë gjatë vizitës në institucion rezulton kontroll periodik i njohurive të marra me anë të testeve apo provimit përfundimtar. Programi në hartimin dhe zhvillimin e tij bazohet në eksperiençat bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p>

#### **Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombe.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Marketing është i hartuar duke iu referuar përvojave më të mira bashkëkohore europiane dhe të vendit, si edhe duke vlerësuar nevojat e tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve janë ndërkombe rish konkuruese për nga elementet që përbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>Mbështetur në lëndët që përfshihen në të, programi i studimit arrin të trajtojë të gjithë elementët e nevojshëm që lehtësojnë njohjen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit, për qëllim vazhdimin e studimeve apo punësimin e studentit.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjisacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	

#### **Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.**

<p><b>Kriteri 1</b> Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p>	<p>Programi i studimit, përmes kurrikulës, që kombinon teorinë me praktikën dhe me punësimin në procesin e mësimdhënies të stafit me përvaja profesionale, synon aftësimin profesional dhe për kërkim shkencor të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p>	<p>Programi i studimit është në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UET dhe drejtimet e miratuara për kërkimin shkencor.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p>	<p>Mbeshtetur në vleresimet periodike që bën institucioni personeli akademik angazhohet në punën kërkimore jo vetëm në interes të ecjes përparrë profesionalisht, por dhe për të përbushur detyrimet sipas kontratës së nënshkruar me UET. Rritja e punës së tyre kërkimore shkencore i</p>
<p><b>Kriteri 4</b> Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon</p>	

me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.	shërbën edhe rritjes cilësore të mesimdhenis ne kete program. Drejtimet kërkimore të pedagogëve përkojnë me qëllimet dhe objektivat e programeve të studimit të fushës përkatëse.
---	---

### Standardi I.7 - Programet e studimeve “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.

**Kriteri 1** Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

**Kriteri 2** Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master Profesional” synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.

Programi i studimeve të ciklit të dytë Master Profesional në Marketing ofrohet në përputhje me nevojat e tregut të punës të cilat përcaktohen mbi bazën e studimeve të tregut të realizuara nga UET.

Programi ka natyrë aplikative dhe ofron formim praktik, duke plotësuar nevojat për sektorët përkatës të ekonomisë, sipas profilit të ofruar.

### Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.

**Kriteri 1** Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;

**Kriteri 2** Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:

- a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar;
- b. kërkesat e punëdhënësve;
- c. një parashikim të përafert për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program;
- d. numrin e të regjistruarve në programe të ngashme në institucionet simotra.

Programi i studimeve Master Profesional në Marketing merr parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohet në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar.

Konsultimet me përfaqësues të tregut të punës, rekomandimet e Bordit të Punës dhe të studentëve Alumni, mendimi i studentëve që ndjekin studimet në këtë program si dhe takimet me grupe ekspertësh përmes projektit PERFORM, mundësojnë vlerësimin e nevojave të tregut të punës, ku përfshihen: mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafert për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngashme në institucionet simotra.

### Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.

**Kriteri 1** Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;

**Kriteri 2** Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.

Programi i studimit është në përputhje me këto dy kriterë. Gjatë hartimit dhe rishikimit të programeve të studimit janë mbajtur parasysh objektivat kombëtare të zhvillimit. Në qendër është formimi i studentëve që të janë të aftë për punë në shërbim të shoqërisë.

### Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**Kriteri 2** Programet e studimeve “Master Profesional” realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.

Programi që po vlerësohet që nga viti akademik 2016-2017, ofrohet me 60 kredite. Kohëzgjatja normale e programit është 1 vit akademik. Punimi i diplomës realizohet me 14 ECTS.

**Kriteri 3** Programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë përfundojnë me marrjen e diplomës “Master i Shkencave”. Ato realizohen me jo më pak se 300 kredite europiane ECTS (360 kredite europiane ECTS për studimet në fushën e mjekësisë). Kohëzgjatja normale e programeve të integruarë të studimeve është jo më pak se 5 vite akademike (6 vite për studimet në fushën e mjekësisë).

N/A.

### Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.

**Kriteri 1** Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësish i konsultueshem për studentët;

**Kriteri 2** Informacioni për programet e studimit, modulet

Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET.

Gjithashtu në fillim të secilit semestër studentët pajisen në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike me të

dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	gjithë syllabuset e lëndëve. Ky informacion tashmë është edhe pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahës syllabusit
--	--

## Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruar të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.

**Kriteri 1** Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;

**Kriteri 2** Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.

Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam dhe konfirmuam që UET ka dokument të shkruar që shpjegon dhe instrukton studentët për procedure dhe menyrën e përgatitjes së punimit te diplomës edhe per nivelin e dytë të programeve ku perfshihet edhe MP ne Finance. Ky dokument u behet i qartë studentëve dhe gjatë periudhes së përgatitjes është punimit te diplomes udheheqesi mbikqyre edhe zbatimin rregullave te percaktuara ne kete document.

Bazuar në programin mësimor për realizimin e programeve të studimeve "Master Profesional" janë parashikuar 14 kredite për projektin kërkimor dhe tezën

### Konkluzionet e vlerësimit:

Në mënyrë të përbledhur konkludojmë si më poshtë:

Ka një ndarje e balancuar e ngarkesës mësimore nëpër semestra.

Lëndët në program renditen në mënyrë që të plotësojnë formimin kërkimor dhe profesional që programi ofron. Studentët e programit të studimit marrin të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me programin e studimit, lëndët e modulet e tij. Çdo fillim semestri atyre u vihet në dispozicion në forma të ndryshme programi dhe syllabuset e lëndëve që ofrohen.

Të dhënat e detajuara për programin e studimeve gjenden të publikuara edhe në faqen e internetit të universitetit [www.uet.edu.al](http://www.uet.edu.al)

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pas shqyrtimit të kritereve të standardeve në lidhje me politikat e formimit të studentëve, arrin në konkluzionin se politikat e formimit të studentëve të ndjekura nga UET janë bashkëkohore, transparente dhe të mirëstudiara në rang kombëtar dhe ndërkombëtar. Megjithatë mendojmë se ka vend për përmirësimë në përbajtjen e planit mësimor.

### Rekomandojmë:

- Lënda "Metoda kërkimi të avancuara + Statistikë sociale", të zhvillohen si dy lëndë të veçanta, në grupin e lëndëve me veprimtari formimuese të tipit (A),
- Lënda "Metoda kërkimi të avancuara" mund të zëvendësohet me një lëndë më në përputhje me masterin profesional, p.sh. "Kërkime Tregu"
- Lënda "Marketing Shërbimesh" të kalojë në grupin e lëndëve me veprimtari formimuese të tipit (B).
- Lënda "Reklama dhe Promocioni" të emërtohet "Komunikimi i Integruar Marketing", pasi nuk përputhet emërtimi me përbajtjen e saj.
- Lënda "Tregje dhe strategji turizmi" nuk e justifikon veten në këtë nivel masteri. Për këtë profil do të sygjerohim lëndë që i ndihmojnë më shumë studentët në aftësimin e tyre profesional në lidhje me shërbimet në turizëm, si p.sh. lëndë që trajtojnë aspekte të manaxhimit dhe të marketingut të shërbimeve turistike, të cilësisë së shërbimeve turistike etj.

Këto sygjerime janë bërë edhe në takimin me stafin e programit i cili i ka pranuar ndryshimet e propozuara. Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion

GVJ konkludon se standardet plotësohen kryesisht për këtë rubrikë.

## 8. Mësimdhënia

### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** organizimi i mësimdhënieve, format e mësimdhënieve, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënieve, teknologjite e mësimdhënieve, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënieve, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Mësimdhënia dhe të nxënët në UET organizohen në një sërë metodash tradicionale dhe innovative me bindjen se kombinimi i metodave të ndryshme çon në të nxënët aktiv. UET promovon metoda innovative dhe të orientuara drejtë studenteve, aktive dhe kreative të mësimdhënieve dhe të nxënët. Pedagogët inkurajohen të zhvillojnë leksione me debate, diskutime brënda në klasë, punime individuale dhe në grupe brenda dhe jashtë auditorit. UET angazhohet në sigurimin e standardeve të larta të mësimdhënieve dhe të nxënët teorik dhe praktik. Personeli akademik bën të gjitha përpjekjet që studentët të kuptojnë thellësisht konceptet bazë, teoritë dhe praktikat dhe aplikon metoda të ndryshme për kontrollin e shkallës së përvetësimit të lëndëve nga studentët.

Cilësia e të nxënët monitorohet dhe matet nga një sërë mekanizmash. Për një vlerësim sa më real të cilësisë së mësimdhënieve UET i referohet indikatorëve të cilësisë siç janë: niveli i kualifikimit të pedagogëve, mendimi i studentëve, mjetet didaktike, literatura në dispozicion, vlerësimi i studentëve dhe ndërthurja e mësimdhënieve me punën kërkimore – shkencore.

Vlerësimi i cilësisë së mësimdhënieve së personelit akademik kryhet përmes:

- praktikës së leksioneve të hapura, e cila zhvillohet në një nga temat e planifikuara, me pjesëmarjen e kolegëve të interesuar; Nga takimi me drejtuesin e Departamentit te Menaxhimit dhe Marketingut ne konfirmuam kete.
- vlerësimi të studentëve që kryhet në fund të semestrit, i cili ruan anonimatin e tyre;
- vlerësimi të Dekanit dhe/ose Përgjegjësit të Departamentit përkatës/ose grupit *ad hoc*, i ngritur me urdhër të Rektorit, në raste të veçanta të evidentimit të nevojës për përmirësimin e cilësisë;
- vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori, në fund të çdo viti akademik (follow-up).

Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoritetet e drejtuese

Sekretaria Mësimore mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimit, leksione/seminare. Ajo raporton në fund të çdo javë, për orët e pazhvilluara te Sekretari i Përgjithshëm, te Dekanët e Fakulteteve dhe te Zyra e Burimeve Njerëzore. Dekani dhe Përgjegjësi i Departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin i cili ishte i shpallur.

### Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

#### Llojet e Formave të mësimdhënieve, për lëndët/modulet:

Bazuar në rolin që luan çdo disiplinë mësimore në formimin e studentit, lëndët grupohen në 6 kategori disiplinash: Kategoria (A): Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë; Kategoria (B): Disiplina të formimit karakterizues të programit; Kategoria (C): Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese, Kategoria (D): Disiplina të zgjedhura; Kategoria (E): Veprimitari formuese për njohje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike, praktika dhe Kategoria (F): Përgatitja e tezës së diplomës. Lëndët sipas kategorive zhvillohen me një strukturë të specifikuar në tabelën e mëposhme.

Në tabelë jepen format e mësimdhënieve si dhe ngarkesa totale në orë e programit të studimit sipas formave të mësimdhënieve.



### Programi i Studimit Master Profesional në Marketing

Format e mësimdhënies		Orët totale në auditor
a.	Leksione	168
b.	Seminare	84
c.	Ushtrime/Projekt/Detyra	108
d.	Laboratore	-
e.	Praktikë lëndore	-
f.	Praktikë profesionale	220
g.	Etj (Seanca metodologjike për diplomën)	20
<b>Në total</b>		<b>600</b>

**Format e kontrollit të njojurive**

Kontrolli i njojurive në UET lidhet me qëllimet dhe objektivat e programit të studimit. Përdoren një sërë metodash vlerësimi dhe testimi, për disa forma të procesit të mësimdhënies, të tilla si frekuentimi, diskutimet në klasë, esetë, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar.

Në tabelëm e mëposhtme jepen format e kontrollit të njojurive pjesa që zë secila prej tyre në totalin e vlerësimit të studentit.

Format e kontrollit të njojurive	Pjesa (në %) ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	40%
Etj	-
<b>Në total</b>	<b>100%</b>

**Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.**

Në verifikuam qe studentët e programit MP në Marketing nuk janë të përfshirë në komponentët e aktivitetit shkencor të njësisë.

#### Të dhënat janë marrë nga RVB

Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar	
	Departamenti Menaxhim & Marketing	Programi i studimit: MP Marketing
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	8	0
Për projekte shkencore në rang Departamenti	0	-
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	0	0
Për projekte shkencore në bashkëpunim me të tjera	0	0

#### 9. Studentët

##### Pjesa përshkrimore

**Terma reference:** procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Pranimi i studentëve në programin MP në Markeitng që ofrohet nga UET bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam me zgjedhje procesin e regjistrimit të studentëve në këtë program duke parë

përmbajtjen e dosjeve të studenteve të regjistruar. Në dosjen e regjistrimit gjendeshin dokumentet e plotësuara të mëposhtme:

- Formulari i interesimit
- Kopje e noterizuar e diplomës të ciklit të parë që studenti ka fituar;
- CV-në e kandidatit, ku paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afërsisht 500 fjalë) ku paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë.
- Një projekt-ide ku paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit.
- Dy Letra Rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studimet në këtë nivel.
- Paraqitja e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

Të gjitha dokumentet e mësipërme dorëzohen në Zyrën e Kontratave. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përzgjedhur. Çdo kandidat i përzgjedhur zhvillon një intervistë në Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit. Sekretaria mësimore e UET-se disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazëviti akademik.

Disa të dhëna mbi shpërndarja e studentëve sipas profileve për tre vitet e fundit jepen në **Tabelën 15** në **Aneksin 7**.

Për të motivuar studentët dhe për të garantuar cilësinë UET ofron bursa të ndryshme studimi të cilat mund të janë të plota ose të pjesshme. Bursat janë të llojeve të ndryshme si bursa ekselence, bursat sociale, bursat e lidershipit dhe bursat e talentit. Universiteti mbështet me bursa më shumë studentët e regjistruar në programet Master i Shkencave, krahasuar me ata në programet Master Profesional. Në vitin e fundit, në krahasim me të dhënat e vitit akademik 2015-2016 bursat e akorduara për studentë të programeve MP kanë rënë nga 33% e totalit të bursave në programet Master, në 20% e tyre. Kjo shpjegohet edhe me kategorinë e studentëve që ndjekin programet Master profesional, të cilët përgjithësisht janë individë në marrëdhënie pune që duan të riorientojnë studimet e tyre në përputhje me kompetencat dhe aftësitë e këruara nga vendi i punës.


Disa të dhëna statistikore mbi bursat e shpërndara nga UET për studentët jepen në **Tabelat, 16, 17 dhe 18** në **Aneksin 7**.

### **Vlerësimi i Tregues të matshëm:**

#### **Procedurat e pranimit të studentëve**

Pranimi i studentëve i nënshtrohet një procedure përzgjedhëse, nën drejtimin e organit përgjegjës për organizimin dhe administrimin e programit të studimit, duke u bazuar në formularin e aplikimit dhe në dokumentacionin e paraqitur nga aplikanti. Përzgjedhja e kandidatëve për studentë për programet e ciklit të parë bëhet nga një komision përkatës i caktuar nga Këshilli i Fakultetit. Numri i pranimeve bazohet në mundësitë reale të çdo fakulteti të UET për një mësim normal dhe brenda standardeve të këruara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren dhe Statutin e UET .

#### **Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve**



Gjatë vizitës ne Institucion GVJ konstatoi se UET përpinqet që të ruajë standarde rigorozë në dalje të studentëve , për të garantuar cilësinë e diplomës që lëshohet në përfundim të programit të studimit. Në tabelat 19 dhe 20 në aneksin 7 gjejmë të dhëna mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe të diplomuar dhe mbi notën mesatare në hyrje dhe në dalje për studentët e programit Master Profesional në Markeking sipas tre profileve të tij për 4vitet e fundit. Por për të analizuar cilësinë në hyrje dhe dalje po i referohemi dy viteve akademike 2015-2016 dhe 2016-2017 më të plotësuar me të dhëna. Nga analiza e të dhënavë shohim se midis notës mesatare në hyrje dhe notës mesatare në dalje për këto dy vite ka një diferencë afersisht me një notë më të lartë në dalje. Po kjo diferencë ruhet edhe në vlerat e larta dhe të ulta të notave.

**Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare**

Që nga viti 2011-2017 për të gjitë këtë periudhë në Masterin Profesional në Marketing në total, janë regjistruar në vitin e parë, për herë të parë **203** studentë nga të cilët:**156** në masterin me **60** kredite dhe **47** ne masterin me **90** kredite për periudhën 2011-2016..

Profili “**Shërbime dhe turizëm**”që nga viti 2011 deri në vitin 2013 nuk ka patur fare studentë, edhe për vitet e tjera ka një numër të kufizuar studentësh. Shih **Tabelën 20 në Aneksin 7**

**Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare**

Në vitin akademik 2016-2017 Në Masterin Profesional në Marketing janë diplomuar gjithësej **23** studentë nga 40 të regjistruar me një mesatare note **7.21** nga **6.51** që ka qenë në hyrje. Vëmë re se numri i studentëve që arrijnë të diplomohen pa vite përsëritëse është i ulët. Nota mesatare në dalje, e cila është pak më e lartë se nota mesatare në hyrje e studentëve, mund të shpjegohet me faktin se vetëm studentët më të mirë të kursit arrijnë të diplomohen brenda kohëzgjatjes normale të programit të studimit.

**Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend**

Nga të dhënt e raportit të GVB shohim se në UET në vitin akademik **2015-2016**, janë transferuar 4 studentë në total, në masterin profesional në marketing. Shih **Tabelën 21 në Aneksin 7**.

**Të dhëna për punësimin e studentëve**

Universiteti European i Tiranës, nëpërmjet Shoqatës Alumni, në mënyrë periodike mban kontakte të vazhdueshme me ish-studentë të cilët kanë kryer një cikël studimesh pranë UET ku qëllimi i saj është jo vetëm ndarja e eksperiencave dhe arritjeve profesionale të gjithsecilit por edhe krijimin e urave efektive lidhëse midis universitetit e tregut të punës. Qëllimi i ALUMNI është të ndihmojë në mënyrë të barabartë dhe pa asnjë dallim të gjithë studentët dhe të diplomuarit e UET të identifikojnë dhe të përbushin qëllimet e tyre të karrierës. Duke ofruar kontakte, programe të kuptueshme, këshillim karriere, mundësi intershipi dhe punësimi Universiteti European i Tiranës mundëson edukimin e studentëve dhe të sapodiplomuarve se si të marrin vendime për karrierën, të zhvillohen profesionalisht dhe të arrijnë qëllimet e jetës akademike dhe profesionale. Të gjithë të kontaktuarit informohen mbi qëllimin e administrimin e mbledhjes së të dhënavë mbi statusin e punësimit dhe mundësitë e mbështetjes nga universiteti. Tentohet të mblidhen informacione sa më të detajuara lidhur me statusin e punësimit të ish studentëve, pozicionin si dhe institucionin në të cilin ata angazhohen.

**Numri total të diplomuarve**

Numri total i të diplomuarve në këtë program studimi për periudhën pas akreditimit të parë, që nga viti 2011 deri në vitin akademik 2015-2016, është 59 studentë. Shih **Tabelën 22 në Aneksin 7.**

**Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)**

Numri total i të punësuarve në përputhje me diplomën për periudhën që nga viti 2011 deri në vitin akademik 2015-2016, nga studentët e diplomuar në programin e studimit Master Profesional në Marketing me tre profile të ofruar nga UET është 18 dhe 3 të punësuar jo në përputhje me diplomën. Shih **Tabelën 22 në Aneksin 7.**

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zoterojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Nga verifikimi me zgjedhje që ne bëmë pranë sekretarisë mësimore konstatuan se në këtë program janë regjistruar studentë, të cilët kanë diplomë bachelor me 180 kredite ose diplomë të sistemit 4 vjeçar.
<b>Kriteri 2</b> Pranimi në programet e integruarë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Të gjithë studentët e regjistruar në këtë program rezultuan që plotësonin kriteret e përcaktuara nga UET, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
<b>Kriteri 3</b> Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Në përputhje me ligjin e ri për arsimin e lartë studentëve të programeve "Master Profesional" nuk u kërkohet më mbrojtja e gjuhës së huaj, as si kriteri në hyrje, as në dalje.
<b>Kriteri 4</b> Studentët e këtyre programeve të studimit jepin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruarë të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	Politikat e pranimit vlerësohen vazhdimesht nga UET me qëllim përmirësimin e ecurisë së studentëve. Politikat e pranimit të studentëve kanë ardhur duke u konsoliduar. Megjithatë, vlen të theksojmë se në UET përpara fillimit të vitit akademik organizohen takime pune për të vlerësuar çfarë ka nevojë të përmirësohet për vitin në vijim dhe ndryshimet e nevojshme në dokumentacionin rregullues.
<b>Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Informacioni mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtij programi studimesh, për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si dhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion u jepet studenteve në forma të ndryshme. UET vë në dispozicion të studentëve të interesuar për të vazhdur studimet e master grupe pedagogësh, sipas fakulteteve, të cilët jepin të gjithë informacionin e nevojshëm.
<b>Kriteri 2</b> Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;	Zyra e Karrierës mbështet studentët gjatë gjithë
<b>Kriteri 3</b> Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	

	kohëzgjatjes së studimeve duke shpërndarë informacione mbi mundësitë e punësimit, mundësitë për vazhdimin e specializimeve e doktoratës brenda ose jashtë vendit.
<b>Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarar të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruarar të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vittit akademik;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>Gjatë vizitës GVJ konstatoi që ekziston statistika të plota pranë Zyrës së Protokollit, Arkivit dhe Statistikave lidhur me tregues të programit. Këto statistika merreshin nga zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore. Institucioni i analizon këto të dhëna për të nxjerrë konkluzione të vlefshme për procesin e vendimmarrjes.</p> <p>Nga verifikimi i bërë konstatohet se UET mban statistika të detajuara në lidhje me studentët e regjistruar, studentët me bursë, studentët e transferuar, ata që kanë ndërprerë studimet për një periudhë afatshkurtër, ata që janë çregjistruar si edhe ata të diplomuar për çdo program studimi.</p> <p>Përgjegjëse për përpunimin e statistikave në nivel institucioni, që koordinon Sekretarinë Mësimore, Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës eshtë Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikave.</p>
<b>Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarar të studimeve të ciklit të dytë.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruarar të studimeve të ciklit të dytë si dhe përvendet e punësimit të tyre;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>UET disponon një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programit të studimeve, përvendet e punësimit të tyre si dhe vazhdimin e studimeve në UET ose institucionë të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Zyra e Karrierës dhe shoqata Alumni janë organizma që mbajnë kontakte me studentët në lidhje me këto të dhëna.</p> <p>UET organizon çdo vit takimin me UET Alumni. Të diplomuarit zgjedhin një kryetar dhe nëpërmjet tij UET mban lidhje me ta, përvësish e tyre dheritjet në sferën profesionale, megjithatë</p>
<b>Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.</b>	
<p><b>Kriteri 1</b> Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p><b>Kriteri 3</b> Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Gjithë informacioni për programet e studimeve, afatin e përfundimit, organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit i bëhet i ditur studentëve që në momentin e regjistrimit dhe në vijimësi përmes faqes së universitetit, u dërgohet elektronikisht si edhe shpallet në tabelat e njoftimeve.</p> <p>Studentët informohen individualisht për rezultatet e vlerësimit përmes sistemit UMIS dhe LMS.</p> <p>Pedagogët zhvillojnë seanca svaruese me studentët, përvësish e sqaruar çdo paqartësi të mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer.</p>

#### **Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.**

**Kriteri 1** Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;

**Kriteri 2** Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

UET ndjek ecurinë e studentëve, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tyre, duke ofruar konsulencë për çështje akademike dhe studentore nëpërmjet Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit shërbim ky i kombinuar edhe me këshillimin që jepet nga personeli akademik gjatë orëve të tutoriatit dhe këshillimit akademik.  
Zyra e Karrierës është në shërbim të studentëve. Ajo ka krijuar kontakte me kompani private e institucionale shtetërore duke bashkëpunuar jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të tyre në këto organizata.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET zbaton kërkësat ligjore dhe kritere të përcaktuara prej tij në pranimin dhe regjistrimin e studentëve Shërbimi i kujdesit ndaj studentit shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij. Krahas këshillimit që ofrohet nga personeli akademik përmes tutoriatit dhe këshillimit akademik, studenti në UET mund t'i drejtohet edhe Zyrës së Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyrës së Karrierës, për të marrë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET. Vëmendje e veçantë i kushtohet mendimit dhe kërkesave të studentëve ekselentë, me të cilët janë zhvilluar vazdimisht focus grupe për të marrë informacion në lidhje me apektet që kanë nevojë të përmirësohen, por edhe nevojave dhe ndihmës ndaj studentëve që kanë mbetur prapa me studime, duke u ofruar mbështetjen e nevojshme, në bashkëpunim me strukturat drejtuese të UET, për të kapërcyer vështirësitet që mund të jenë bërë pengesë për mbarëvajtjen e studimeve.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pas shqyrtimit të kritereve të standardeve në lidhje me studentët vlerëson se **këto standarde janë të plotësuara plotësisht nga UET.**

### **KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.**


#### **10. Kërkimi shkencor**

##### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projekte të fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënen.

Dokumentat e paraqitura në materialet e GVB dëshmojnë për një veprimitari mjaft të pasur kërkimore-shkencore të personelit akademik të UET. Për UET, kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë një pjesë kryesore e strategjisë së zhvillimit institucional. Kërkimi shkencor në UET bazohet në gamën e gjerë të ekspertizës që ka në shkencat sociale, humane, ekonomike dhe teknologjite e informacionit, edukimit, dhe komunikimit. Në dekadën e dytë të jetës së tij, UET është i fokusuar në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për mobilitetet e stafit dhe forcimin e portofolit të kërkimit. UET ofron mobilitete për studentët, stafin dhe kërkuesit për avancimin e kërkimit shkencor dhe ritjen e standardit te produktit të kërkimit shkencor. Gjatë periudhës 2015-2017 UET ka dërguar 51 anëtarëve të stafit, ku 30 prej të cilëve ishin për qëllime kërkimore/mësimore. Për të njëjtën periudhë UET ka pritur 18 punonjës nga universitetet e BE-së, 15 prej të cilëve kanë kryer aktivitete hulumtuese/mësimore. Për periudhën 2015-2017 UET ka zbatuar 12 Marrëveshje Ndër-institucionale brenda Erasmus + ICM si dhe menaxhimin e projektit SIGMA Agile Tempus.

UET ka pritur 13 studentë të huaj, nga të cilët 6 kërkues doktorantë dhe 1 student MA që ka kryer kërkime për tezën e tij, ndërsa nga UET ne drejtim të universitete të BE, kanë shkuar 38 studentë, nga të cilët 6 studentë të doktoraturës. Aktualisht, UET ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me CEU-Budapest dhe është bërë pjesë e Programit CEU të Ndihmës Globale. Duke filluar nga shtatori



2017, UET do të jetë institucioni pritës për lektorët dhe kandidatët e avancuar të doktoratës të CEU, të cilët do të jepin mësim dhe ndërmarrin kërkim shkencor në UET. Gjithashtu, për vitin akademik 2017-2018 UET ka aplikuar për 31 marrëveshje Erasmus + për të mundësuar mobilitetë për 207 studentë dhe kërkues.

Mobilitetet tregojnë se UET është angazhuar që studentët, stafi dhe kërkuesit e tij të njihen me praktikat më të mira akademike Europiane në mënyrë që personeli të trajnohet vazhdimesh, të jetë në kontakt me avancimet e fundit në fushat e tyre përkatëse, e për të aplikuar në UET standartet më të larta të mësimdhënies dhe kërkimit. Ristrukturimi i revistave shkencore, trajnimi i vazhdueshëm i stafit lidhur me hulumtimin dhe publikimin dhe mbështetja me një mekanizëm të përshtatshëm financimi, bën të mundur që stafi akademik i UET të ketë njëkohësisht njojuritë dhe mbështetjen për t'u angazhuar në kërkime akademike me standarde të larta dhe me ndikim në botën akademike dhe politike.

**Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

**Të dhëna për kërkimin shkencor**

UET ka një pozicion të dedikuar ndaj Kërkimit Shkencor, që është posti i Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. UET është i angazhuar të ndërmarrë kërkim të avancuar shkencor për të prodhuar njojuri të vlefshme për botën akademike dhe për të mundësuar përparimin e shoqërisë shqiptare.

UET publikon dy revista shkencore ndërkontinentale: **Economicus** (ISSN: 2223-6295) dhe **Polis** (ISSN: 2223-8174). Economicus publikon kërkime në fushën e ekonomisë, zhvillimit dhe IT, ndërsa Polis publikon kërkime në fushën e shkencave humane dhe shoqërore. Revistat publikojnë artikuj vetëm në gjuhën angleze.

UET siguron trajnime për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim si dhe trajnime për botime dhe kryerjen e kërkimeve në grup të organizuara në seminare të ditore që ofrohen në fund dhe fillim të kalendarit akademik., gjithashtu UET siguron mbështetje financiare për kërkimin shkencor, duke dedikuar 500,000 euro në vit. Akademikët në UET inkurajohen që të hulumtojnë dhe të publikojnë dhe në bazë të performancës marrin grantet e tyre kërkimore. Çdo departament i dorëzon në fillim të vitit akademik Zv/Rektorit për Kërkim Shkencor dhe Metodologjinë kalendarin e aktiviteteve shkencore si dhe mbledhja e fundit të muajit në çdo departament ka për tematikë kërkimin shkencor brenda departamentit, zhvillime të reja në fushën e botimeve, promovimin dhe pjesëmarrjen e stafit në konferanca.

**Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL**

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL është **150** për vitin **2016-2017**, **120** për vitin **2015-2016** dhe **186** për vitin **2014-2015**.

**Numri i projekteve kërkimore të fituara**

Numri i projekteve kërkimore të fituara janë 8 për vitin 2015, 2 për vitin 2016 dhe 1 në vitin 2017.

**Numri i projekteve të zbatuara**

Numri i projekteve të zbatuara janë 11 per vitin 2015, 5 për vitin 2016 dhe 4 për vitin 2017.

**Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL**

Numri i aktiviteteve shkencore të organzuara nga IAL për vitin 2015 është 3, për vitin 2016 është 5 dhe për vitin 2017 është 5.

**Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL**

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL për vitin 2015 është 70, për vitin 2016 është 80 dhe për vitin 2017 është 120.

**Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor, numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor**

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor për vitin 2015 është 4, për vitin 2016 është 3 dhe për vitin 2017 është 10.

Të dhënat e mësipërme janë marrë nga RVB, konkretisht nga tabela nr.19, faqe 58 të atij rapporti. Kjo tabëlë gjendet në aneksin nr. 8 që shoqëron vlerësimin e GVJ me nr 23.

**Vlerësimi sipas Standardeve**

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve	
<b>Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organzuara në kuadër të programit të studimeve.</b>	<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Personeli akademik i UET publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në revistën e tij Economicus si dhe në revista të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p>Personeli akademik i UET, nëpërmjet angazhimeve në veprimtaritë kërkimore shkencore jep ndihmesën e tij në zhvillimin e sektorëve të veçantë të ekonomisë të prodhimit apo të shërbimit.</p>
<b>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</b>	<p><b>Kriteri 1</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zotëron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvojë në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>Në kuadër të projekteve të mobilitetit Erasmus +, UET pret studentë të huaj, që kanë zhvilluar një semestër të plotë.</p> <p>Mësimdhënia për to zhvillohet me seanca të përqëndruara, në gjuhë angleze, nga pedagogë shqiptarë, të shkolluar në Institucion që përdorin anglishten si gjuhë zyrtare.</p>
<b>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet mëtejshëm të personelit të tij.</b>	<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut dhe si njësia e mbulimit të programit MP në Marketing, realizon leksione të hapura me pjesëmarje pedagogë të huaj apo specialist të mirnjohur të fushës së marketingut, me synim marrjen e përvojës metodologjike dhe pedagogjike nga stafi i Departamentit.</p> <p>UET organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor në mënyrë periodike.</p>

	UET u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.
--	--

### **Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.**

**Kriteri 1** Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

**Kriteri 2** Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;

**Kriteri 3** Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.

Secili Fakultet ka në dispozicion Axhendën Kërkimore të secilit pedagog në harkun e 5 viteve, si dhe një bazë të plotë të dhënash të studimeve shkencore të stafit.

Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet dhe pjesemarrijet në konferenca brenda dhe jashtë vendit të stafit akademik të angazhuar në këtë program studimi.

Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhëna për projektet kërkimore në të cilat ka marrë pjesë ose është aktualisht i përfshirë personeli akademik.

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET ka bërë progres në drejtim të organizimit dhe bashkërendimit të punës kërkimore shkencore të personelit akademik, në rang departamenti e më gjerë.

Ka një infrastrukturë të përshtatshme në dispozicion të angazhimit të pedagogëve në veprimtar kërkimore shkencore.

Revistat shkencore të UET ofrojnë një hapësirë të mirë për publikimin e rezultateve të punës kërkimore të personelit akademik.

Zyra e Projekteve ndihmon për të identifikuar projekte dhe koordinuar përfshirjen e pedagogëve në projekte që përputhen me interesat dhe ekspertizën e tyre shkencore.


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pas shqyrtimit të kritereve të standardeve në lidhje me kërkimin shkencor vlerëson se janë të plotësuar plotësisht të gjitha standaret.

## **11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëni me publikun**

### **Pjesa përshkrimore**

**Terma reference:** bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

UET gjatë 3 viteve të fundit akademike (2014-2015) ka rritur nivelin e bashkëpunimit në nivel lokal dhe ndërkombëtar, gjë që kontribon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal partneritet, shkëmbime akademie apo Erasmus +, me 15 institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me 16 institucione të tjera të shoqërisë publike. UET bashkëpunon me institucione të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit publik dhe atij privat me qëllim kryimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Në mënyrë të veçantë ai bashkëpunon me Universitetin e Aston-it në Britaninë e Madhe në akademik. Në mënyrë të veçantë ai bashkëpunon me Universitetin e Jean Monnet, Erasmus+ si dhe me institucioneve të tjera në kuadër të programeve mbështetëse për



kërkimin nga donatorë ndërkombe tar dhe lokal si Regional Research Promotion Programme; NUFFIC, Assist Impact/USAID, Fondacioni Shoqëria e Hapur, American-Albanian Development Fund, Sëiss Development Cooperation, Agjencitë e UN, etj. Në vitin 2014-2015 UET ndërmerr iniciativën e ndërtimit të rrjetit ‘*Next Europe*’, nën kujdesin e Zyrës së Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim. Rrjeti *Next Europe* iniciohet nga Universiteti Europian i Tiranës dhe përbëhet nga universitetet lider në Ballkanin Perëndimor (Universiteti i Beogradit, Sarajevës, Podgorica, UGD, Universiteti i Europës Juglindore në Maqedoni) si edhe nga qendra kërkimore në Europë (si LSE Research on South East Europe, Sciences Po, European University Institute, American University Bulgaria, Center for South East European Studies Graz, UCL School of Slavonic and East European Studies). UET është pjesë e Rrjetetarë Ndërkombëtarë të Universitetetëve si SEUN-Rrjet partnerësh mbi startup, sipërmarrjen rinore dhe inovacionin (Spanjë); UNIMED- Rrjet universitetesh mesdhetare me qëllim shkëmbimin e stafit dhe studentëve (Itali); FEDE-Rrjet europian universitetesh me qëllim kërkimin shkencor (Portugali). UET ka marrëveshje institucionale për kërkimin shkencor me La Sapienza University of Rome, Itali, me fokus seminare doktorale si dhe Central European University, Budapest, me fokus programin “Global Teaching Fellowship” për shkëmbim stafi akademik. Mobiliteti i stafit akademik dhe studentëve realizohet në kuadër të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit Europian; të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 të Komisionit Europian; Visegrad University Fund në bazë të marrëveshjeve të veçanta me institucione të tjera në kuadër të thirrijeve të projekteve kërkimore bilaterale si Shqipëri-Austri dhe Shqipëri-Turqi etj (aplikuar nga AKTI); sipas aplikimeve individuale të stafit për të kryer periudha kërkimore në universitete të tjera jashtë. Gjatë vitit 2015-2017 janë kryer 107 mobiliteti staf dhe student nga UET drejt Universitetetëve partnere. 18 staf dhe 13 student kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus + gjatë 2015-2017.

### **Vlerësimi i Treguesve të matshëm:**

#### **Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombe tar (sipas RVB)**

<b>1</b>	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombe tarë	13
<b>2</b>	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	37
<b>3</b>	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	30 (erasmus + staf akademik)
<b>4</b>	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	13 student kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus + 38 student nga UET kanë përfituar bursa Erasmus + 19 student të UET kanë lëvizur përmes programeve të tjera të BE (SIGMA) dhe programeve bilaterale
<b>5</b>	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Biblioteka, Abonimi në EBSCO, SAGE online si edhe të tjera burime online; Laborator IT; infrastrukturë anti-plagjarizëm; Salla konferencash

	dixhiitale; trajnimi i brendshëm i stafit akademik: Kërkimi me Impakt; Si të komunikojmë Shkencën; UET Research group; Si të aplikojmë për projekte; etj.	
	Ditët Doktorale; Revstat Shkencore (Economicus dhe Polis); Ditë Informative për grante kërkimore në nivel European (AKTI, RCE, etj.); Ditët e Studimeve Shqiptare;	
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	21 (erasmus + staf administrativ)
7	Numri i Çmimave ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:**

Bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë është si më poshtë:

- UET bashkëpunon me 109 institucione të arsimit të lartë brenda dhe jashtë vendit.
- UET bashkëpunon me 16 institucione të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare si partnerë ose donatorë.

Të dhënat në lidhje me bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun janë marrë nga RVB, konkretisht; gjenden edhe në tabëlat nr 24, 25, 26 në aneksin nr. 9 që shoqëron vlerësimin e GVJ.

#### Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
<b>Standardi V. 3- Institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij.</b>	
<b>Kriteri 1</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme të parashikuara për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me ndërmarrje apo sipërmarrje nga fusha e tregtisë, industrisë apo e shërbimeve prodhuase;	Për realizimin e programit të studimeve “Master Profesional”, UET ka marrëveshje bashkëpunimi me institucione dhe kompani të fushave të ndryshme. Nëpërmjet bashkëpunimit me këto kompani, synohet rritja e njohurive dhe aftësimit profesional, shkencor e praktik të studentëve që ndjekin këtë program studimi duke patur këto kompani prioritarë për të dërguar studentët në praktika profesionale dhe në përfshirjen e drejtuesve të këtyre kompanive në leksione të hapura në programet Master duke përcuar praktikën dhe eksperiencën e tyre tek studentët.
<b>Kriteri 2</b> Për kryerjen e praktikave të ndryshme në programin e studimeve “Master i Shkencave” ose në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, institucioni dëshmon se ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm nga sfera publike dhe ajo private që mundësojnë përfitimini e njohurive më të mira profesionale nga ana e studentit.	
<b>Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të tij.</b>	

<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;</p> <p><b>Kriteri 2</b> Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.</p>	<p>Personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në hartimin dhe rishikimin e programeve të studimit të departamentit. Të gjitha propozimet diskutohen në departament, duhe shkëmbyer mendimet në lidhje me përmirësimet e nevojshme.</p> <p>Ndarja e detyrave në lidhje me procesin mësimor dhe mbarëvajtjen e zhvillimit të programit të studimit është e përcaktuar në aktet rregullatore të institucionit dhe zbatimi i tyre monitorohet vazhdimesht.</p>
<p><b>Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.</b></p>	
<p><b>Kriteri 1</b> Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;</p>	<p>UET, për realizimin e objektivave të programeve të studimeve, ka vendosur lidhje bashkëpunimi me institucionet homologe vendase dhe të huaja, për shkëmbimin e stafit dhe studentëve, si dhe me aktorët e biznesit për të rritur përputhshmërinë e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës.</p>
<p><b>Kriteri 2</b> Institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofron;</p>	<p>UET ka marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës profesionale dhe organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit.</p>
<p><b>Kriteri 3</b> Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;</p> <p><b>Kriteri 4</b> Institucioni bën një raport analistik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>UET analizon ecurinë dhe rezultatet e këtyre bashkëpunimeve, duke u përpjekur të identifikojë mënyra e mjete për të rritur nivelin dhe cilësinë e këtij bashkëpunimi dhe impaktin e tij në programet e studimit.</p>

#### **Konkluzionet e vlerësimit:**

UET ka krijuar lidhje të qëndrueshme me mjaft institucione të administratës publike të komunitetit të biznesit dhe organizatave joftimprurëse.

Ai ka marrëdhënie bashkëpunimi me aktorë të biznesit vendas apo të huaj për kryerjen e praktikave të studentëve të tij, garanton marrëdhënie të mira bashkëpunimi mes personelit si dhe marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.


UET zhvillon çdo vit edhe Panairin e Punës për të lehtësuar kontaktin e studentëve me kompani nga më të rëndësishmet në Shqipëri, me synim punësimin e mundshëm të studentëve në to.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pas shqyrtimit të kritereve të standardeve në lidhje me bashkëpunimin kombëtar, ndërkombëtar vlerëson se janë të plotësuar plotësisht të gjitha standartet

### **ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT**

#### **I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË**

Në përfundim të vlerësimit të programit të studimit Master Profesional në Marketing me tre profile GVJ vlerëson se struktura organizative e UET është në përputhje me misionin objektivat e tij për të ofruar programe studimi cilësore. Të gjitha strukturat departamenti, fakulteti, strukturat operative dhe deri në nivel universiteti janë të angazhuar në realizimin e programit të studimit Master Professional në Marketing me detyra të përcaktuara në aktet rregullatore të institucionit. Për realizimin e programit të studimit në këtë master institucioni ka bërë përpjekje për plotësimin e departamentit përgjegjës për këtë program me pedagogë të brendshëm (sot rreh 90% e e pedagogëve të përfshirë në mësimdhënie janë të brendshëm). Institucioni ndjek dhe mbështet rritjen së shkallës së kualifikimit të personelit akademik në fushat përkatëse me veprimtari didaktike, trajnime, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në konferanca shkencore brenda dhe jashtë vendit, me publikimin e punës së tyre kërkimore dhe me mbështetje financiare në formën e granteve kërkimore. Ai ka



mbështetur kualifikimin e pedagogëve për të ndjekur studimet e doktoratës në UET, ose në institucionë jashtë vendit, duke akorduar periudha disa mujore kërkimi shkencor të paguar. Të gjithë titullarët e lëndëve që zhvillohen në këtë program studimesh kanë minimalisht gradën shkencore doktor.

Kurrikula mbi të cilën zhvillohet programi siguron një ndarje të balancuar të ngarkesës mësimore nëpër semestra, lëndët dhe modulet zhvillohen bazuar në tekste bazë të botuara nga shtëpitë botuese prestigjioze ndërkombëtare, dhe në materiale në gjuhën shqipe. Megjithatë mendojmë se ka vend për përmirësimë në përmbajtjen e planit mësimor. Kështu mendojmë që lënda Metoda kërkimi të avancuara + Statistikë sociale, të zhvillohen si dy lëndë të veçanta, në grupin e lëndëve me veprimtari formimues të tipit (A) dhe lënda Metoda kërkimi të avancuara mund të zëvendësohe me një lëndë më në përputhje me masterin profesional, p.sh. "Kërkime Tregu". Lënda Marketing Shërbimesh të kalojë në grupin e lëndëve me veprimtari formimues të tipit (B). Lënda Reklama dhe Promocioni të emërtohet "Komunikimi i Integruar Marketing, pasi nuk përputhet emërtimi me përmbajtjen e saj. Lënda Tregje dhe strategji turizmi nuk e justifikon veten në këtë nivel masteri. Për këtë profil do të sygjeronom lëndë që i ndihmojnë më shumë studentët në aftësimin e tyre profesional në lidhje me shërbimet në turizëm, si p.sh. lëndë që trajtojnë aspekte të manaxhimit dhe të marketingut të shërbimeve turistike, të cilësisë së shërbimeve turistike etj.

UET ka një bashkëpunim të gjerë me mjafit institucionale të tjera në arsimin e lartë brenda dhe jashtë vendit si dhe me aktorë të tjerë të shoqërisë civile, sektorit publik dhe atij privat me qëllim krijimin e hapësirave dhe mundësive të ndryshme për studentët si edhe stafin akademik. Në funksion të shkëmbimit të përvojave me universitetet e tjera vendase apo të huaja, sikurse dhe për të qenë sa më pranë kërkësave të tregut të punës, UET ka institucionalizuar angazhimin e lektorëve të ftuar si dhe përfshirjen e ekspertëve të fushave të ndryshme në ato lëndë ku gjyket se përfshirja e ekspertëve është e rëndësishme. Përpala fillimit të secilit semestër, titullari i lëndës i propozon shefit të departamentit emrat e ekspertëve të cilët gjykojnë të përshtatshëm për të mbuluar 1-3 tema në lëndë të caktuara, që më pas miratohen nga Rektori i UET. Ekspertët e ftuar janë emra të spikatur në fushën ekonomike, juridike, politike dhe sociale. Gjithashtu, institucioni bashkëpunon me profesorë të huaj, në udhëheqje temash doktorature dhe në konferanca ndërkombëtare që organizohen nga UET.

Për përzgjedhjen dhe pranimin e studentëve dhe për sa i përket kriterit të njohjes së gjuhës së huaj, UET ndjek legjislacionin në fuqi, për arsimin e lartë. UET ndjek politika të mbështetjes dhe nxitjes së përfshirjes së studentëve në kërkimin shkencor. Kjo mbështetje realizohet nëpërmjet: përfshirjes së studentëve në projektet kërkimore të pedagogëve, udhëheqjes së punimeve të diplomës të cilat bazohen në parimet, metodologjinë dhe instrumentet bashkëkohore të kërkimit shkencor, përfshirjes së studentëve në projektet ku UET është partner dhe mobilitetit të tyre në kuadër të programeve Erasmus+. Nga analiza u vu re se studentët e këtij programi studimi nuk janë të përfshirë në këto veprimtari. UET disponon infrastrukturë dhe lehtësira më së të mjaftueshme për zhvillimin e këtij programi studimi.

Nga sa më lartë konkludojmë se nga shtatë rekomandimet e dhëna **nga akreditimi i parë, gjashtë prej tyre janë përbushur plotësisht nga UET**. Këtu bën pëtjashtim rekomandimi lidhur me **integrimin e studentëve në kërkimin shkencor, ku mendojmë se ky rekomandim është plotësuar kryesisht, pasi studentët e Masterit Professional në Marketing nuk janë të angazhuar në asnjë lloj projekti studimi, qofshin këto studime tregu apo projekte kërkimore-shkencore në bashëpunim me pedagogët.**

## ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR IMPLEMENTIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

RVJ mbyll me "Analizën përbledhëse të RVJ" sipas metodës SWOT (Strengths-pikat e forta, Weaknesses- pikat e dobëta, Opportunities-mundësítë, Threats-pengesat).

### a. Pika të forta:

1. Niveli i kualifikimit të stafit akademik dhe mbulimi i programit të studimit tërësisht me staf të brendshëm, ç'ka garanton përkushtim më të madh dhe kontakte më të shpeshta me studentët. Në tërësinë e tij stafi është me grada dhe eksperiencë.
2. Akreditimi institucional disa vjeçar rrít reputacionin dhe kërkësën potenciale të studentëve.
3. Aksesi në bibliotekë online ofron mundësi për një punë të pavarrur clësore dhe angazhim më të madh të studentëve. Biblioteka ka libra nga autorët dhe shtëpitë botuese të njohura.
4. Shërbim i konsoliduar i kujdesit ndaj studentit, që shtrihet nga momenti i regjistrimit të studentit e deri në diplomimin e tij.

5. Infrastruktura në dispozicion të angazhimit të pedagogëve në veprimtari kërkimore shkencore.
6. Konsolidimi i veprimtarive lidhur me sigurimin e cilësisë dhe të monitorimit të sigurimit të saj, në veprimtarinë mësimore dhe të kërkimit shkencor.
7. Bashkëpunim të gjërë dhe të qëndrueshëm me shumë universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit më institucionë të administratës publike, të komunitetit të biznesit dhe organizatave jo fitimprurëse.
8. Mjediset e pajisura me pajisje dhe mjete didaktike bashkëkohore, krijojnë mundësi për zhvillim cilësor të procesit të mësimit.
9. Mobiliteti i stafit dhe i studentëve përmes bursave Erasmus +, Erasmus +, 19 programeve të tjera të BE dhe programeve bilaterale.

**b. Pika të dobëta:**

1. Kompletimi i personelit mësimdhënës me pedagogë të brendshëm kufizon angazhimin e stafit të specializuar me përvaja aplikative në fusha të caktuara.
2. Program i studimit me numër relativisht të kufizuar lëndësh nuk e ka optimizimin e duhur për përgatitjen e duhur të studentëve, për më tepër ka theksuar më shumë lëndët e karakterit strategjik, që janë më të përshtatshme për programe studimi të karakterit shkencor.
3. Mosangazhim të studentëve të masterit profesional në projekte kërkimi në treg, gjë që zvogëlon afësitë konkurruese në treg të të diplomuarve.
4. Tarifa relativisht të larta krahasuar me tregun, gjë që mund të cenojnë cilësinë në dalje të studentëve.
5. Numri relativisht i kufizuar i studentëve, gjë që zvogëlon mundësitë e përzgjedhjes cilësore të studentëve.
6. Literaturë e kufizuar në gjuhën shqipe, ndërkohë kur, për studentët e MP nuk është e detyrueshme gjuha e huaj.

**c. Mundësitë:**

1. Përdorimi më i mirë i mundësive që ofron sistemi i vlerësimit të performancës së pedagogëve për stimul dhe promociion.
2. Tendenca në rritje e besimit të publikut ndaj sektorit privat të lartë, e shtuar edhe nga akreditimi me kompaninë britanike të akreditimit përbën një mundësi për zhvillimin e mëtejshëm të UET, që do të çonte edhe në rritje të kërkesës për këtë program dhe programe studimi të tjera, ç'ka "përkthehet" në më shumë cilësi në përzgjedhjen e kandidatëve.
3. Aktivitete të larmishme promovuese e shkencore dhe lidhja me biznesin e rrit më tej interesin e biznesit për bashkëpunim të ngushtë me UET.
4. Angazhimi për të tretë ofron një mundësi për diversifikimin e burimeve financiare, siguron një lidhje më efektive të institucionit me praktikat e biznesit dhe të institucioneve publike, si dhe një përdorim më racional të kapaciteteve akademike që disponohen.
5. Integrimi i Shqipërisë në tregun global, rrit mundësitë e punësimit të të diplomuarve në këtë program studimi.

**d. Pengesat:**

1. Ndryshimet e shpeshta ligjore, përbëjnë një nga pengesat kryesore të konsolidimit dhe jetëgjatësisë të universitetit.
2. Konkurenca nga programe të ngjashme që ofrojnë universitete të tjera në Shqipëri dhe më gjërë.
3. Ndryshimi i shpejtë i tregut të punës duke konsideruar integrimin europian, që kërkon riorganizimin e programeve më të përputhshme me tregun punës, por duke qenë se UET, është në një fazë riorganizimi të programeve, kjo gjë përbën edhe një mundësi.
4. Hapja e shkollave profesionale, përbën kërcënim për zvoglimin e kërkesës për këto programe.

## **SUMMARY ANALYSIS FOR THE STUDY PROGRAM IMPLEMENTATION**

**a. Strengths:**

1. The level of qualification of the academic staff and the full coverage of study program with internal staff, guarantees greater dedication and more frequent contact with the students. The staff generally holds academic degrees and is experienced.
2. Several-year institutional accreditation enhances the reputation and potential demand of students.
3. The access to online library provides opportunities for independent, high quality work and greater student commitment. The library has books from well-known authors and publishing houses.
4. Consolidated Student Care Service extended from student enrollment until graduation.
5. Infrastructure available to the involvement of lecturers in scientific research activities.
6. Consolidation of activities related to the quality assurance and monitoring of its assurance, in teaching and scientific research activity.
7. Wide and sustainable cooperation with many other universities at home and abroad with public administration institutions, business community and non-profit organizations.
8. Facilities equipped with contemporary didactic equipment and tools prepare the ground for high quality development of the learning process.
9. Mobility of staff and students through Erasmus + scholarships, 19 other EU programs and bilateral programs.

**b. Weaknesses:**

1. Teaching staffing with full time lecturers limits the involvement of specialized staff with applicative experience in specific areas.
2. The study program with a relatively limited number of subjects does not have the proper optimization for the proper preparation of students. Further, it has rather highlighted the subjects of strategic character that are most suitable for study programs of a scientific character.
3. Non-engagement of Professional Master students in market research projects, which reduces the competitive skills of graduates in the market.
4. Relatively high fees compared to the market, which may affect the quality of the “product” of this study program.
5. Relatively limited number of students, which reduces the opportunities for high quality selection of students.
6. Limited literature in Albanian language, while for MP students, foreign language is not obligatory.

**c. Opportunities:**

1. Better use of the opportunities provided by the lecturer performance evaluation system for stimulus and promotion.
2. The growing trend of public confidence in the private sector of higher education, coupled with accreditation with the British accreditation company, represents an opportunity for further UET development, which would also lead to increased demand for this program and other study programs, which is translated into higher quality in the selection of candidates.
3. Various promotional and scientific activities and business connectivity further grows the business interest for close cooperation with UET.
4. Commitment for third parties paves the way for diversification of financial resources, provides a more effective link of the institution with the business practices of public institutions, and more rational use of the available academic capabilities.
5. The integration of Albania into global market increases the employment opportunities of graduates in this study program.


**d. Threats:**

1. The constant legal amendments represent one of the main obstacles to the University consolidation and further continuity of the University activity.
2. Competition from similar programs offered by other universities in Albania and beyond.
3. Rapid change of the labor market considering European integration, requiring the reorganization of the most compatible programs with the labor market, but since UET is in a phase of reorganizing the programs, it also represents an opportunity.
4. The opening of vocational schools represents a threat to the reduction of demand for these programs.

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof. Dr. Shyqyri LLACI**

**Prof. As. Dr. Vita KOJA**



## Aneksi 1

### Universiteti European i Tiranës / Struktura organizative 2016-2017




Tabela 1. Struktura e Fakulteteve të UET

FAKULTETI	DEPARTAMENTI/QËNDRA
Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit	Departamenti Financës dhe Ekonomiks Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut Departamenti i Matematikës, Informatikës dhe Statistikës
Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit	Departamenti i Komunikimit dhe Marrëdhënieve me Publikun Departamenti i Shkencave Sociale të Aplikuara Departamenti i Edukimit
Fakulteti Juridik	Departamenti i të Drejtës Private Departamenti i të Drejtës Publike Qendra e Studimeve Ligjore

Tabela 2. Njësítë administrative të UET

NR	NJËSIA ADMINISTRATIVE
1	Zyra e Burimeve Njerëzore
2	Sekretaria Mësimore
3	Zyra e Zhvillimit të Kurrikulave
4	Zyra e Kujdesit ndaj Studentit
5	Zyra e Financës
6	Zyra e Kontratave
7	Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikës

